



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në
“Informatikë Ekonomike”
Universiteti “Metropolitan” Tirana”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Irma Shyle

Dr. Blerta Leka (Moçka)

Qershor /2024

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Bachelor në "Informatikë Ekonomike"**

1	IAL aplikues:	Universiteti "Metropolitan Tirana"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti Informatikë Ekonomike
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në "Informatikë Ekonomike"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASR Nr. 492 datë 27.07.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditim për herë të parë
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vjet/6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Angleze
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	Viti 2023-2024 14 PAE/12 PAK
18	Numri i studentëve:	2021-2022 4 studentë 2022-2023 18 studentë 2023-2024 22 studentë
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti "Metropolitan Tirana" u licencua me vendim Nr. 357, datë 12.05.2010 të Këshillit të Ministrave me statusin e Shkollës Private e Arsimit të Lartë "Universiteti Metropolitan Tirana". Pas miratimit të statutit me UMASR Nr. 611, date 28.09.2018, institucioni është riorganizuar nga SHPAL në Universitet me UMASR Nr. 195, datë 01.04.2019. Universiteti "Metropolitan Tirana" është akredituar me VBA nr. 45 date 05.07.2019, deri me datë 14.12.2022.

Fakulteti i Ekonomisë është një nga tre njësitë kryesore të Universitetit "Metropolitan Tirana". Ky fakultet synon të arrijë standarde akademike dhe pajisjen e studenteve me dije dhe njohuri praktike të cilat do ti ndihmojnë ata të përballen me tregun kombëtar dhe ndërkombëtar. Programi i studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" është pjesë e programeve të studimit të ciklit të parë të ofruara nga Fakulteti i Ekonomisë. Ky program studimi është hapur me Urdhër të MASR Nr.492, datë 27.07.2018 për hapjen e programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" në Universitetin Metropolitan Tirana.

Programi i studimeve Bachelor në "Informatikë Ekonomike" ofrohet në përputhje me vizionin dhe misionin e Departamentit Informatikë Ekonomike. Ky program studimi ka për qëllim tu ofrojë të diplomuarve, kompetenca të avancuara profesionale për formimin në fushën e teknologjisë së informacionit dhe ekonomisë, por jo vetëm. Gjithashtu ky program studimi gërsheton njohuri teorike dhe praktike për të inkurajuar te studenti mendimin kritik dhe krijues si dhe për ti ekspozuar ata drejt çështjeve bashkëkohore dhe kyçe në fushën e ekonomisë dhe informatikës.

Ky program studimi ofrohet në përputhje me Ligjin 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë" dhe akteve nënligjore në funksion të tij. Studentët e këtij programi kanë mundësinë të zhvillojnë leksionet në ambiente komode, për sa i përket zhvillimit të leksionit, si dhe kanë akses në facilitete si biblioteka, laborator, etj.

Universiteti Metropolitan Tirana ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe kompani të ndryshme, gjë kjo e cila do të lehtësojë procesin e praktikave të studentëve. Specifikojmë se studenti në këtë program studimi, sikurse edhe në cdo program tjetër studimi të ofruar në këtë institucion, është në qëndër të vëmëndjes si për departamentin dhe për institucionin që e ofron këtë program. Lektorët paraqiten të angazhuar dhe ofrojnë profesionalizën dhe transparencë në punën e tyre.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” ofruar nga Departamenti Informatikë Ekonomike pranë Fakultetit të Ekonomisë të Universitetit Metropolitan Tirana, filloi me trajnimin, prezantimin si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm.

Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), filloi shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit, GVJ ka shqyrtuar dhe analizuar mjaft dokumente dhe informacione të përgatitura nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për këtë proces vlerësimi. Gjithashtu një informacion i plotë dhe i detajuar është marrë edhe gjatë vizitës në Fakultetin e Ekonomisë të zhvilluar në datat 29 dhe 30 Janar 2024 sipas një agjende të hartuar nga GVJ me asistencën e ASCAL.

Gjatë kësaj vizite 2-ditore, GVJ zhvilloi takime me: Dekanin e FE dhe Përgjegjës të Departamentit Informatikë Ekonomike, me Zyrën e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, me përfaqësues të Zyrës së marrëdhënieve me jashtë, projekteve / pranimeve dhe këshillimit për karrierën, grupin e vlerësimit të brendshëm (GVB), me stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore, stafin e Sekretarisë Mësimore si dhe studentët që ndjekin programin e studimit. Gjatë këtij takimi u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit në fjalë, duke sqaruar edhe elementë të veçantë, për të cilat ishin ngritur pyetje përkatëse.

Pas vizitës në IAL, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm filloi punën për të hartuar raportin e vlerësimit të jashtëm bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitave të realizuara në këtë IAL. Vlerësimet për çdo standard dhe fushë synojnë të paraqesin objektivisht performancën e institucionit në ofrimin e këtij programi studimi.

Procesi është koordinuar nga ASCAL në përputhje me afatet e përcaktuara me të cilat grupi i vlerësimit të jashtëm është njohur që në fillim të angazhimit të tij. Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga Prof. Asoc. Irma Shyle dhe Dr. Blerta Leka (Moçka). Gjatë gjithë këtij procesi GVJ është asistuar nga Koordinator teknik i ASCAL Rajna Lila. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon raportin tek eksperti përkatës i ASCAL.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Informatikë Ekonomike”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Programi i studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike ofruar nga Departamenti Informatikës Ekonomike pranë Fakultetit të Ekonomisë (FE), në Universitetin Metropolitan Tirana (UMT), është hartuar duke marrë parasysh traditën e IAL-së, nevojat e tregut të punës si dhe ecurinë e proceve zhvillimore të vendit. Programi synon pajisjen me kompetenca dhe aftësi të nevojshme në menaxhim, sistmet e informacionit dhe proceset që lidhen me të dhe nuk bie ndesh me interesat dhe vlerat kombëtare.</p> <p><i>Aneksi Nr.14, Rregullore e programit të studimit në Bachelor në “Informatikë Ekonomike”- Anglisht, neni 7, 8.</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Programi i studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” është pjesë e programeve të studimit të ciklit të parë të ofruara nga Fakulteti i Ekonomisë, i cili është hapur me Urdhër të Ministrisë së Arsimit Nr.492, datë 27.07.2018 për hapjen e programit të studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” në UMT. Ky program ofrohet në përputhje me vizionin dhe misionin e departamentit Informatikë Ekonomike. Programi studimi ka për qëllim t’u ofrojë të diplomuarve, kompetenca të avancuara profesionale për formimin e ekspertëve në fushën e informatikës Ekonomike. Gjithashtu ky program studimi gërsheton njohuri teorike dhe praktike për të inkurajuar te studenti mendimin kritik dhe krijues si dhe për ti ekspozuar ata drejt çështjeve bashkëkohore dhe kyçe në fushën e menaxhimit në fusha të ndryshme të inxhinierisë suke synuar vazhdimisht zbatimin e parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm.</p> <p><i>Aneksi Nr.14, Rregullore e programit të studimit në Bachelor në “Informatikë Ekonomike”- Anglisht, neni 7, Objektivat formues të programit</i></p>

<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimit akademike të tij.</p>	<p>Programi i studimit ofrohet në përputhje me misionin dhe qëllimin e IAL-së, për formimin akademik të studentëve në fushën e shkencave të aplikuara dhe informatikës, ekonomisë etj. Nga analiza e dokumentacionit dhe vizita në institucion, ky program studimi është në përputhje të plotë me sa më sipër dhe ofron mundësinë që studentët të ndjekin studimet e ciklit të dytë duke rritur mundësitë për diversifikimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të karrierës së tyre profesionale.</p> <p><i>Aneksi Nr.2, Statuti i UMT, Neni 4. Misioni I UMT</i></p> <p><i>Aneksi Nr.14, Rregullore e programit të studimit në Bachelor në "Informatikë Ekonomike"- Anglisht</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Ky program studimi pajis studentët me aftësi teorike dhe praktike, i zhvillon njohuritë dhe aftëson studentët në përshtatje me tregun e punës. Gjithashtu ky program studimi gërsheton njohuri teorike dhe praktike për të inkurajuar te studenti mendimin kritik dhe krijues si dhe për ti ekspozuar ata drejt çështjeve bashkëkohore dhe kyçe në fushën e menaxhimit në fusha të ndryshme të inxhinierisë suke synuar vazhdimisht zbatimin e parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm. Ky program studimi synon në përgatitjen jo vetëm profesionale të studentëve por synon gjithashtu në përgatitjen e studentëve për të ndikuar në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit. Vizioni i programit të studimit është të pregatisë "Lidera të mendimit dhe të veprimit" duke dhënë kështu kontribut në zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë në vend.</p> <p><i>Aneksi Nr.14, Rregullore e programit të studimit në Bachelor në "Informatikë Ekonomike"- Anglisht</i></p>
<p>Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe</p>	<p>Ky program studimi i ofron studentëve kompetenca dhe njohuri në fusha të tilla si: ekonomia, informatika, rrejtet kompjuterike, etj. Klasifikimi dhe kodifikimi i programeve të studimit respektonë standardet dhe udhëzimet kombëtare dhe evropiane.</p> <p>GVJ gjykon se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë kryesore dhe asaj bazë përgjegjëse për programin e studimit. Struktura e programit të studimit Bachelor "Informatikë Ekonomike" është e organizuar sipas veprimtarive formuese të përcaktuara në VKM nr. 41 datë 24.01.2018 dhe ndryshimeve të përcaktuara për të (VKM nr.185 datë 25.03.2021). Njësia bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit në proces akreditimi është Departamenti</p>

udhëzimeve kombëtare e evropiane.	i Informatikës Ekonomike, ndërsa njësia kryesore Fakulteti i Ekonomisë. <i>Aneksi Nr.14, Rregullore e programit të studimit në Bachelor në "Informatikë Ekonomike"- Anglisht, neni 7, Objektivat formues të programit</i> <i>Aneksi Nr.25 Plani mësimor</i> <i>Aneksi Nr.26, Plan programet e lëndëve syllabuset.</i>		
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se UMT ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Njësia bazë në fund të vitit akademik, por jo vetëm, edhe gjatë vitit akademik, analizon procesin e mësimdhënies dhe ecurisë së programit të studimit. Gjithashtu, në fillim të cdo viti akademik, përcaktohet Plani Vjetor i Punës në FE. Po kështu, secili prej pedagogëve të angazhuar në programin e studimit në fund të vitit akademik plotëson formularin për aktivitetin akademik dhe profesional dhe dorëzon një plan për vitin e ri. Ky dokumentacion përbën bazën vlerësimi të punës, ndarjes së detyrave dhe planifikimit të veprimtarive. <i>Aneksi Nr.2, Statuti i UMT, neni 8.</i> <i>Aneksi Nr.10, Organigrama e FE</i> <i>Aneksi Nr.60, Raport vjetor i aktiviteti mësimor, kërkimor dhe shkencor- FE Viti 2022-2023.</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit	UMT ka bashkëpunime dhe marrëveshje bashkëpunimi me institucione/ kompani publike për zhvillimin e praktikave

<p>mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>profesionale dhe aktiviteteve të tjera me profil akademik në fushën e ekonomisë, financave dhe e inxhinierisë. Për Fakultetin e Ekonomisë, 21 subjektet bashkëpunuese i përkasin sektorit publik, privat, sektorit financiar etj. Përsa i përket marrëdhënieve me jashtë, UMT, ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi në kuadër të programit Erasmus Mobility me 20 Universitete në BE si dhe jashtë saj sikurse edhe 2 marrëdhënie bashkëpunimi në kuadër të seminareve. Gjithashtu UMT ka marrëdhënie bashkëpunime edhe me Institucione të Arsimit të lartë në vend.</p> <p><i>Aneksi Nr.20, Lista e marreveshjeve te bashkepunimit ne kuader te praktikave FE</i></p> <p><i>Aneksi Nr.19, Lista e shkembimeve kombetare dhe nderkombetare UMT</i></p> <p><i>Aneksi Nr.22 Lista e universiteteve bashkëpunuese në kuader të programit ERASMUS.</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizmin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Siç është përmendur edhe më sipër, institucioni ka marrëdhënie bashkëpunime me institucione publike dhe subjekte private për zbatimin e praktikave studentore por edhe për shkëmbimin e eksperiencave dhe zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta. Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me IAL jashtë vendit në kuadër të programit Erasmus jo vetëm për stafin akademik por edhe për studentët. Një tjetër element që e lehtëson, punën e institucionit, është se shumica e studentëve të programit janë të punësuar, para ose gjatë periudhës që ata regjistrohen në program.</p> <p><i>Aneksi Nr.20, Lista e marreveshjeve te bashkepunimit ne kuader te praktikave FE</i></p> <p><i>Aneksi Nr.19, Lista e shkembimeve kombetare dhe nderkombetare UMT</i></p> <p><i>Aneksi Nr.22 Lista e universiteteve bashkëpunuese në kuader të programit ERASMUS.</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në</p>	<p>Për cdo periudhë 1 vjecare, institucioni në nivel fakulteti, harton raporte analitike të të dhënve që lidhen me këtë program studimi të tilla si: angazhimin dhe ngarkesa e stafit akademik, numri i studentëve të rregjistruar dhe të diplomuar, marrëveshjet e bashkëpunimit në kuadër të projekteve dhe programeve të mobiliteti Erasmus etj.</p>

funksion të realizimit të programit të studimit.	<i>Aneksi Nr.6, Raport vjetor i aktiviteti mësimor, kërkimor dhe shkencor- FE Viti 2022-2023.</i>			
Konkluzione	<i>UMT siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” është program i ciklit të parë i organizuar në module/lëndë të cilat kanë kreditet përkatëse ECTS, në përfundim të të cilit lëshohet diploma bachelor. Sikurse është përmendur edhe më sipër, programi ka 180 ECTS, zhvillohet në tre vite akademike të ndarë në 6 semestra dhe zbaton përcaktimet e ligjit 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” me nenet përkatëse si dhe VKM nr 41. Ndarja në kategoritë përkatëse, ndarjet e orëve për çdo lëndë me kreditet përkatëse për çdo semestër, përcaktohen në rregulloren e programit dhe planin mësimor të tij duke reflektuar kërkesat e akteve nënligjore në fuqi të miratuara nga MASR.
	<i>Aneksi Nr.2, Statuti i UMT.</i>

	<p><i>Aneksi Nr.14, Rregullore e programit të studimit në Bachelor në "Informatikë Ekonomike"- Anglisht.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.26, Plani mësimor i programit studimor</i></p> <p><i>Aneksi Nr.27, Plani mësimor sipas llojit të veprimtarisë A-E.</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi synon formimin profesional të profileve bashkëkohore të studjuesve të rinj, në fushën e menaxhimit të programeve e të projekteve dhe në teknikat e përdorura për zhvillimin efikas të tyre duke ndërthurur njohuritë me aplikimin e tyre. Nëpërmjet programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike", studentët thellojnë njohuritë në drejtim të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sistemet dhe programet ekonomike; • Algoritmat dhe gjuhët e programimit; • Sistemet e menaxhimit të informacionit; • Strategji marketing; • Rrjeta kompjuterike, etj; <p>Në përfundim të këtij programi studimi, i diplomuari është në gjendje të analizojë probleme e të japë zgjidhje përmes një tërësie instrumentesh si edhe të përfshihet në vendimmarrje manaxheriale.</p> <p><i>Aneksi Nr.14, Rregullore e programit të studimit në Bachelor në "Informatikë Ekonomike"- Anglisht.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.25, Plani mësimor i programit studimor</i></p> <p><i>Aneksi Nr.26, Plani mësimor sipas llojit të veprimtarisë A-E.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Ky program organizohet në module/lëndë me kredite ECTS dhe lëndët grupohen sipas VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018 si vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> A. Lëndë bazë që përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme – 5 lëndë, 30 kredite ECTS (16.7 % e totalit të krediteve); B. Lëndë karakterizuese, që lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik – 16 lëndë, 96 kredite ECTS (53.3 % e totalit të krediteve); C. Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese në një ose më shumë grupe disiplinash, të ngjashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit dhe grup-lëndë me zgjedhje – 4 lëndë me

	<p>zgjedhje, 24 kredite ECTS (13.33 % e totalit të krediteve);</p> <p>D. Lëndë plotësuese - praktikat profesionale –4 lëndë, 24 kredite ECTS (13.33 % e totalit të krediteve të këtij programi);</p> <p>E. Detyrime përmbyllëse, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës – 6 kredite ECTS (3,33 % e totalit të krediteve).</p> <p><i>Aneksi Nr.14, Rregullore e programit të studimit në Bachelor në "Informatikë Ekonomike"- Anglisht.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.25, Plani mësimor i programit studimor</i></p> <p><i>Aneksi Nr.26, Plani mësimor sipas llojit të veprimtarisë A-E.</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi i studimit ka 180 kredite ECTS dhe kohëzgjatje 3 vite akademike sipas detyrimeve ligjore. Në këtë program detyrimet përmbyllëse, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës ose provimit të formimit, kanë 6 kredite ECTS ose 3.33 % e krediteve. Teza e diplomës është punë e pavarur në formën e një studimi analitik që lidhet me formimin e marrë gjatë programit. Në përfundim të diplomimit, studenti pajiset me diplomën përkatëse Bachelor në "Informatikë Ekonomike" e cila firmoset nga dekani i FE dhe Rektori i UMT. Nga takimi me studentët që ndjekin këtë program studimi u informuan për procedurën e caktimit të temës me pedagogun udhëheqës. Ky i fundit paraqet një listë me tema të mundshme dhe pasi studenti zgjedh. Pedagogu i dërgon strukturën e punimit. Nga vlerësimi i dosjes së dokumentacionit të paraqitur nga IAL, vihet re që studentëve iu mundësohet një udhëzues për përgatitjen e mikrotezes dhe elementëve përbërës të saj si dhe formati që duhet të ndjekë studenti në punimin e saj.</p> <p><i>Aneksi Nr.3, Rregullore e UMT.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.14, Rregullore e programit të studimit në Bachelor në "Informatikë Ekonomike"- Anglisht.</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 37, Rregullore e provimeve</i></p> <p><i>Aneksi Nr.49. Procedurat e përgatitjes dhe mbrojtjes së diplomës</i></p>
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet</p>	<p>Në UMT është bordi i administrimit i cili vendos për tarifën e studimit dhe financimin e studentëve me status të veçantë.</p>




<p>e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p><i>Aneksi Nr.2, Statuti i UMT</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Gjatë takimeve në institucion dhe nga dokumentacionet e dorëzuara vihet re se programi i studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” është një program studimi i ngjashëm me programin e studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” i cili ofrohet në gjuhën shqipe në këtë Fakultet. Këto programe kanë një përpushmëri të programit mësimor mbi 70%. Ato vetëm gjuha dhe kushtet e pranimin i diferencojnë. Në programin “Informatikë Ekonomike” studentët duhet të kenë të mbrojtur gjuhën Angleze dhe të kenë një mesatare të lartën në hyrje, që për vitin 2024-2025 ka qenë mbi 8.</p> <p><i>Aneksi Nr.67, Kriteret e pranimin per vitin akademik 2024-2025</i></p> <p><i>Webpage: https://umt.edu.al/wpcontent/uploads/2023/05/BA_Informatike-Ekonomike.pdf</i></p>
<p>Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria e arsimit. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit duke vedosur një kod të vecantë për çdo lëndë ku reflektohet edhe viti që zhvillohet lënda, p.sh IE-302 kodi për lëndë Database, lënda është në vitin e tretë.</p> <p><i>Aneksi Nr.25, Plani mësimor i programit studimor</i></p>
<p>Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>N/A</p>

Konkluzione	<i>Programi i studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” përmban 180 kredite ECTS dhe zhvillohet për tre vite akademike, me qëllim përgatitjen e studentëve në menaxhimin e programeve dhe projekteve ekonomike, duke kombinuar njohuritë teorike me aplikimin praktik. Struktura e programit përfshin lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, praktika profesionale dhe detyrime përmbyllëse për përgatitjen e tezës së diplomës, ndërsa pranimi në program kërkon njohuri të gjuhës angleze dhe një mesatare të lartë akademike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2																						
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.																						
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																					
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>GVJ, bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni, evidenton që njësia kryesore FE dhe njësia bazë Departamenti i Informatikës Ekonomike, për programin e studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. Organizimi i njësisë kryesore bazohet në legjislacionin për arsimin e lartë në fuqi, statutin e UMT-së dhe aktet e tjera nën-ligjore. Aktualisht njësia kryesore, FE, përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike” përbëhet nga 3 departamente:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Shkencave të Administrative; 2. Departamenti i Financë – Bankë; 3. Departamenti i Informatikë Ekonomike; <p>Fakulteti Ekonomik për vitin akademik 2023-2024 ka në përbërjen e tij 76 staf akademik gjithsej, nga ku 21 janë staf akademik efektiv (PAE) dhe 55 janë staf akademik me kontratë (PAK) me kualifikimin e mëposhtëm:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kualifikimi i stafit</th> <th colspan="2">Fakulteti Ekonomik</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>2</td> <td>6</td> </tr> <tr> <td>Prof.Asoc</td> <td>5</td> <td>9</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>9</td> <td>18</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>5</td> <td>22</td> </tr> <tr> <td>Gjithsej</td> <td>21</td> <td>55</td> </tr> </tbody> </table>		Kualifikimi i stafit	Fakulteti Ekonomik		PAE	PAK	Prof.Dr	2	6	Prof.Asoc	5	9	Dr/PhD	9	18	Msc	5	22	Gjithsej	21	55
Kualifikimi i stafit	Fakulteti Ekonomik																					
	PAE	PAK																				
Prof.Dr	2	6																				
Prof.Asoc	5	9																				
Dr/PhD	9	18																				
Msc	5	22																				
Gjithsej	21	55																				

Departamenti i Informatikës Ekonomike që është përgjegjës për programin e studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike”, plotëson detyrimet ligjore për raportin e stafit PAE/ PAK. Në total raporti i orëve që mbulojnë pedagogë PAE për vitin 2023-2024 (sipas parashikimit dhe ndarjes së ngarkesës mësimore) është rreth 67.2% të ngarkesës totale të orëve të zhvilluara për këtë program studimi. Stafi akademik PAK mbulon rreth 32.8% të ngarkesës totale.

Departamenti i Informatikës Ekonomike

Titulli/Grada	2021-2022		2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	1	2	1	2	1	1
Prof.Asoc.	1	-	2	-	1	2
Dr	3	1	3	2	2	4
Msc	2	3	2	2	3	10
Gjithsej	7	6	8	6	7	17

Aneksi Nr.2, Statuti i UMT.

Aneksi Nr.10, Organigrama e FE

Aneks Tabelat, tabela 12.

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.

Në përbërje të programit të studimit, sikurse u përmend edhe më sipër praktika profesionale zë 6 ECTS. Departamenti i Informatikës Ekonomike përcakton për secilin student një mbikqyrës praktike brenda departamentit. Gjithashtu, studenti ka edhe një mbikqyrës praktike në institucionin ky kryen praktikën. Gjithashtu edhe për punimin e diplomës, studenti ka pedagogun udhëheqës i cili e udhëzon dhe e ndjek gjatë gjithë ecurisë së punimit të diplomës.

Aneksi Nr.22, Programi i praktikës

Aneksi Nr.49. Procedurat e përgatitjes dhe mbrojtjes së diplomës

Aneksi Nr.14, Rregullore e programit të studimit në Bachelor në “Informatikë Ekonomike”- Anglisht.

Aneksi Nr. 37, Rregullore e provimeve

<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Për programin e studimit është miratuar koordinatori i programit. Në rregulloren e programit të studimit, në nenin 12 përcaktohen detyrat e tij të cilat lidhen me organizimin dhe koordinimin e aktiviteteve për mbarëvajtjen e programit të studimit. GVJ e vlerëson këtë si një praktikë pozitive për cilësinë e programit të studimit.</p> <p>Koordinatori i programit të studimit ka detyrat e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Bashkëpunon dhe koordinon aktivitetet me strukturat përgjegjëse për zhvillimin e programit të studimit në përputhje me Statutin, rregulloren e UMT dhe të Departamentit përgjegjës për programin e studimit; • Shqyrton çdo kërkesë të studentit e cila depozitohet paraprakisht në sekretarinë mësimore; • Raporton për përmbushjen dhe respektimin e standarteve të cilësisë për ecurinë e programit të studimit; • Të realizojë funksionimin dhe koordinimin e procesit mësimor por edhe atë kërkimor shkencor që lidhet me programin e studimit; <p><i>Aneksi Nr.14, Rregullore e programit të studimit në Bachelor në "Informatikë Ekonomike"- Anglisht, neni 12.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.14 Rregullore e programit të studimit në Bachelor në "Informatikë Ekonomike"- Anglisht</i></p> <p><i>Aneksi Nr.17, Kompetencat e përgjegjesave të programeve studimore.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Fakulteti Ekonomik dhe Departamenti i Informatikës Ekonomike përmbushin kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për organizimin e programit Bachelor në "Informatikë Ekonomike", duke siguruar një strukturë të mirëorganizuar, staf akademik të kualifikuar dhe koordinim efektiv të procesit mësimor dhe kërkimor.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi II.3</p>	
<p>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>FE është njësia kryesore pranë UMT, përgjegjëse për programin e studimit. Duke analizuar dokumentacionin e dërguar, bazuar edhe në vizitën në institucion, GVJ vëren se Departamenti i Informatikës Ekonomike ka informacionet në lidhje me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit. Siç jemi shprehur edhe më sipër, programi i studimit, bazuar në VKM nr. 41, datë 24.01.2018, i ndryshuar ka:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) kreditet ECTS; b) kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit; c) objektivat formues dhe kompetencat profesionale; d) veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit; e) kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë një program studimi; f) planin mësimor; g) kuotat e pranimit; h) programin lëndor; i) profilin e programit; j) diplomën dhe suplementin <p><i>Aneksi Nr.14, Rregullore e programit të studimit në Bachelor në "Informatikë Ekonomike"- Anglisht.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.25 dhe 26, Plani mësimor</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 27 Syllabuset.</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Sikurse edhe më sipër, programi i studimit i përket ciklit të parë dhe organizohet në lëndë me ECTS. Veprimtaria mësimore realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike: leksione; seminare; detyrash apo projektesh; prezantime, provime; përgatitje për provime; përgatitje e tezës së diplomës; praktika profesionale.</p> <p><i>Aneksi Nr.14, Rregullore e programit të studimit në Bachelor në "Informatikë Ekonomike"- Anglisht.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.25 dhe 26, Plani mësimor</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 27 Syllabuset.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe</p>	<p>Ky program ka detajuar në rregulloren e tij bazuar në kriteret ligjore dhe i ka publike, elementet që kanë të bëjnë me kriteret e pranimit dhe transferimit. Kuotat dhe kriteret e veçanta për pranimin e studentëve në programin e studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike", bëhen me vendim të Senatit Akademik, mbështetur në propozimet e Departamentit të</p>

<p>specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Informatikës Ekonomike, miratimin e FE-së, në përputhje me kuotat e akorduara nga ministria e arsimit. Në nenin 16, 17 dhe 18 të rregullores së programit të studimit paraqiten në formë të detajuar kushtet dhe procedurat e pranimit të studentëve në këtë program studimi si edhe dokumentacioni përkatë pranues. Gjithashtu në rregulloren e programit të studimit, neni 21 janë përcaktuar rregullat për transferimin e studimeve.</p> <p><i>Aneksi Nr.14, Rregullore e programit të studimit në Bachelor në "Informatikë Ekonomike"- Anglisht</i></p> <p><i>Aneksi Nr.67, Kriteret e pranimit në programet studimore.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.68, Procedure aplikimi, regjistrimi dhe transferimi.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.63, Raport i MASR mbi certifikimin e kuotave të pranimit në UMT.</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit dhe vizitën në IAL, programi ka syllabuset për secilën lëndë, për praktikat, dhe seminarët. Për syllabuset dhe praktikat respektohen formatet e miratuara për këtë qëllim në VKM nr. 41 datë 24.01.2018. Për mikrotezën dhe praktikën, janë miratuar formatet dhe udhëzime specifike. Analiza e Syllabuseve të detajuara të lëndëve dëshmon se informacioni mbi përmbajtjen dhe formën e organizimit të mësimdhënies, për secilën lëndë të programit, është i detajuar, i plotë dhe i lehtë për t'u përdorur.</p> <p><i>Aneksi Nr.14, Rregullore e programit të studimit në Bachelor në "Informatikë Ekonomike"- Anglisht.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.22, Programi i praktikës</i></p> <p><i>Aneksi Nr.25 dhe 26, Plani mësimor</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 27 Syllabuset.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.49. Procedurat e përgatitjes dhe mbrojtjes së diplomës</i></p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet</p>	<p>Nga takimet në institucion me drejtuesit, stafin dhe përfaqësuesit e zyrës e NJSBC ndryshimet në përmbajtjen e programeve e respektojnë masën 20 %, të shprehur në kredite ECTS. Këto ndryshime bëhen me miratim të Senatit. Për këtë program studimi nuk ka patur ndryshime rrenjësores.</p> <p><i>Aneksi Nr.14, Rregullore e programit të studimit në Bachelor në "Informatikë Ekonomike"- Anglisht.</i></p>




eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	<i>Aneksi Nr.22, Programi i praktikës</i> <i>03-RVB_Shqip.</i>		
Konkluzione	<i>Programi i studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" është i detajuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të ciklit të parë, siç përshkruhet në VKM nr. 41. Dokumentacioni dhe rregullorja e programit përfshijnë kreditet ECTS, objektivat formues, kompetencat profesionale, planin mësimor, kuotat e pranimit, kriteret e transferimit dhe syllabuset e detajuara për çdo lëndë, duke siguruar një strukturë të qartë dhe transparente për studentët.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Sikurse e kemi përmendur më sipër, programi është organizuar në leksione, seminare dhe praktika profesionale me kredite ECTS bazuar në VKM 41 datë 24.1.2018. Në tërësi, GVJ vëren se organizmi dhe zhvillimi i programit dhe shpërndarja e ngarkesës mësimore ETCS i mundëson studentëve arritjen e objektivave të programit dhe përfitim të aftësive profesionale. <i>Aneksi Nr.14, Rregullore e programit të studimit në Bachelor në "Informatikë Ekonomike"- Anglisht.</i> <i>Aneksi Nr.25 dhe 26, Plani mësimor</i> <i>Aneksi Nr. 27 Syllabuset.</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe	GVJ vëren, që lëndët dhe shpërndarja e tyre i mundësojnë studentëve pajisjen dhe zbatimin në praktikë të aftësive metodologjike dhe njohurive teorike të cilat përdoren në projektet, detyrat e kursit si dhe në punimin e mikrotezës. Të gjitha këto lehtësojnë dhe mundësojnë integrimin e të diplomuarve në tregun e punës.

<p>rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p><i>Aneksi Nr.14, Rregullore e programit të studimit në Bachelor në "Informatikë Ekonomike"- Anglisht.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.25 dhe 26, Plani mësimor</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 27 Syllabuset.</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>GVJ vëren se programi i studimit, në strukturë dhe përmbajtje, është i krahasueshëm me programe të ngjashme ndërkombëtare. Konsultimi i vazhdueshëm i programeve të ngjashme brenda dhe jashtë vendit i shërben IAL-së për të ndërtuar një program studimi kompetitiv dhe me impakt në tregun e punës.</p> <p><i>Aneksi Nr.25 dhe 26, Plani mësimor</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 27 Syllabuset.</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Nga vizita në institucion, takimi me pedagogët dhe studentët, GVJ evidentoi se në leksione sikurse edhe në seminare tentohet vazhdimisht gërshetimi i teorisë me situata praktike. Duke patur parasysh edhe faktin që një pjesë e studentëve kur regjistrohen janë të punësuar apo punësohen gjatë periudhës së studimeve, kjo krijon mundësi edhe për diskutime dhe detyra të nivelit me praktik.</p> <p><i>Aneksi Nr.25 dhe 26, Plani mësimor</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 27 Syllabuset.</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Në rregulloren e UMT përcaktohet që syllabuset e lëndëve përditësohen çdo vit akademik. Çdo lëndë ka syllabusin në gjuhën shqipe dhe angleze. Nga takimi me pedagogët e angazhuar në programin e studimit, GVJ vëren se stafi bëjnë përpjekje për të pasuruar literaturën në syllabuset e lëndëve.</p> <p>Propozimet për ndryshimet bëhen nga pedagogët e lëndës, njëisa përgjegjëse për zhvillimin e programit ose nga mbledhjet në department. Ndryshime në planin mësimor apo syllabusin e lëndëve nuk ka pasur duke qenë se ky program është në vitet e para të veprimtarisë dhe në procesin e parë të akreditimit.</p> <p><i>Aneksi Nr.03, Rregullore e UMT.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.25 dhe 26, Plani mësimor</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 27 Syllabuset.</i></p>

<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Nga analiza sidomos e syllabuseve, GVJ vëren se ka përputhje midis titullit të lëndës, objektivave, literaturës dhe instrumentave të vlerësimit. <i>GVJ konstaton se lëndët që zhvillohen në këtë program studimi u ofrojnë studentëve mundësinë e përfimit të dijeve dhe afësitë që nevojiten për programet e studimit Bachelor.</i></p> <p><i>Do të rekomandonim shtimin e sa më tepër punëve aplikative për lëndët e informatikë më së shumti në të cilat studentët të përfitojnë zbatime praktike të tyre.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.25 dhe 26, Plani mësimor</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 27 Syllabuset.</i></p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Sikurse e kemi përmendur më sipër, programi është organizuar në leksione, seminare dhe praktika profesionale me kredite ECTS bazuar në VKM 41 datë 24.1.2018. Sipas ligjit të arsimit të lartë, diplomimi nga një program Bachelor i jep mundësinë studentit, nëse plotëson kriteret e tjera, të vijojë studimet e ciklit të dytë. Ky program studimi i përgatit studentët përsa i përket tregut të punës, studentët mund të punësohen në sektorin privat por nuk përjashtohet edhe sektori publik.</p> <p><i>Aneksi Nr.25 dhe 26, Plani mësimor</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 27 Syllabuset.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" është strukturuar dhe organizuar në përputhje me objektivat formuese dhe nivelin e kualifikimit. GVJ ka konstaton se programi përfshin leksione, seminare dhe praktika profesionale me kredite ECTS, të cilat mundësojnë arritjen e objektivave formuese dhe përfitim e aftësive profesionale. Analiza e syllabuseve tregon se përmbajtja e lëndëve i përgatit studentët për tregun e punës dhe vazhdimin e studimeve të ciklit të dytë, duke integruar teorinë me praktikën në mënyrë efektive.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Standardi II.5




Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përpunje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Universiteti "Metropolitan Tirana" ka një sërë bashkëpunimesh me partnerë, të sektorit publik dhe privat. Ky program këtë vit aplikon praktikat për studentët duke qenë se ende nuk ka informacion mbi përshtatshmërinë e programit dhe nevojave të tregut të punës nga institucionet ku studentët do të zhvillojnë praktikat. Bazuar edhe tek RVB, bazuar tek kërkesat e tregut të punës për programin e studimit në Shqip institucioni merr në konsideratë propozimet e institucioneve partnere për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit.</p> <p><i>Megjithatë, GVJ nuk ka evidentuar procedurën të aplikimit të këtyre ndryshimeve pasi nuk ka asgjë të dokumentuar.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.20, Lista e marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirëimit të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni si edhe nga takimi me studentët u informuam se ato kishin një sërë instrumentash në dispozicion, formalë dhe informalë, për të dhënë mendimin e tyre për programin e studimit, literaturën në dispozicion si dhe qasjen didaktike. Nga takimet në institucion me përgjegjësit e zyrës së karrierës, GVJ u informua se, UMT përpiqet të ruajë kontaktet me studentët e diplomuar dhe kontakton në mënyrë të herëpashershme me ta, për të gjurmuar të diplomuarit si dhe për të ruajtur lidhjet me universitetin. Zyra e këshillimit të karrierës dhe Alumni mban një databazë të marrëveshjeve me biznesin por edhe të Alumnit. Kjo zyrë mban marrëdhënie me të diplomuarit duke i ftuar ata në takime, projekte, vizita studimore dhe leksione të hapura. Po kështu kjo zyrë ofron dhe asistencë për studentët duke i ndihmuar në gjetjen e praktikës, përpilimit të letrës së motivimit, CV etj. Në takimin me studentët u informuam se për një nga lëndët që zhvillon rreth Rrjetave kompjuterike, studentët kishin bërë kërkesë për lehtësimin e trajtimit të temave praktike të kësaj lënde, duke qenë se ajo trajtohet në një nivel mjaft të avancuar, dhe kjo ishte marrë në konsideratë nga departamenti.</p> <p><i>Aneksi Nr.31, Rrjeti Alumni UMT</i></p>




	<p><i>Aneksi Nr.80, Model i pyetësorit të studentit per lenden pedagogun.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.88, Raportete NJSBC për procesin mesimore S1-2020-2021.</i></p> <p><i>Takimi me studentët dhe me përfaqësues të zyrës së karrierës</i></p>			
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua se UMT ka shtuar përpjekjet për të përditësuar dhe përshtatur programet e studimit me kërkesat dhe nevojat e tregut dhe partnerëve të saj kjo edhe falë projekteve në të cikat ka aplikuar dhe në të cilat është partnere. Një kontribut për këtë ka edhe stafi i diplomuar në universitet ndërkombëtare që mban ende kontaktet me ta për të përditësuar programin e studimit sipas përmirësimeve dhe avancimeve në këto universitete.</p> <p><i>Takimet në institucion</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UMT nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre. Ndryshime në progamin e studimit nuk ka pasur duke qenë se ky program këtë vit diplomon brezin e parë të studentëve.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Procesi i mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit harmonizon format tradicionale si leksionet, seminarët, dhe detyrat e kursit me projekte dhe praktika profesionale, duke mbajtur parasysh ngarkesën në orët mësimore të punës individuale dhe orëve në auditor.</p> <p>Në përputhje me udhëzim e VKM nr. 41, dt. 24.1.2018, i ndryshuar, programi i studimit ka një numër total prej 4500 orësh, ku 1825 orë janë për studime në auditor (40.5%) dhe 2765 orë për studime individuale (59.5%). Ky ekuilibër ndërmjet mësimdhënies së drejtpërdrejtë dhe studimit të pavarur siguron që studentët të përvetësojnë thelluar njohuritë teorike dhe të zhvillojnë aftësitë praktike të nevojshme për tregun e punës.</p> <p><i>Aneksi Nr.03, Rregullore e UMT.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.11, Rregullore e FE-UMT.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.25, Plan mesimor</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 27.1/2/3 Syllabuset.</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Personeli akademik përpiqet që të përzgjedhë format më efektive të mësimdhënies duke patur parasysh orën e mësimin, karakteristikat e lëndës, numrin dhe nivelin e mësimnxënies së studenteve, literaturën në dispozicion, gjuhës anglisht të mësimin, si edhe kombinimin e aspektit teorik me atë praktik.</p> <p><i>Takimi me Stafin Akademik dhe me studentët,</i></p> <p><i>Aneksi Nr.14, Rregullore e programit të studimit në Bachelor "Informatikë Ekonomike"-Anglisht</i></p> <p><i>Aneksi Nr.25 dhe 26, Plani mesimor</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike</p>	<p>UMT mbështet personelin akademik në procesin e përmirësimit të mësimdhënies duke mundësuar përdorimin e mjeteve didaktike më të përshtatshme për tematikën e trajtuar përfshirë këtu edhe përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie</p>

<p>dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>dhe trajnimet për përmirësimin e kompetencave pedagogjike. Auditorët janë të pajisura me mjetet e nevojshme didaktike për të prezantuar video ilustruese për mësimdhënien, për të prezantuar leksionet, ndonëse vazhdojnë përpjekjet për përmirësimin e mëtejshëm.</p> <p><i>Vizita në institucion: Vëzhgimi i mjediseve auditorët, laboratorët, dhe shërbimet për studentët etj.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.33, Udhezues per planin e mobiliteteve.</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Në takimin e GVJ me dekanin dhe përgjegjësin e departamentit u theksua se institucioni i kushton rëndësi përzgjedhjes së stafit akademik duke angazhuar staf me tituj e grada, të arsimuar në universitete të huaja për të qen sa më kompetent edhe në trajtimin e lëndëve në këtë program studimi në gjuhën anglisht. GVJ vlerëson që stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie ka përvojën e duhur profesionale dhe akademike në shpjegimin dhe në transmetimin e njohurive dhe koncepteve të cilat ofrohen nga ky program.</p> <p>Numri i PAE në vitin akademik 2023-2024, është 14 dhe numri i PAK është 12. Kualifikimet dhe eksperiencia e përfitur brenda dhe jashtë institucionit, si dhe aplikimet në projekte kombëtare, ndihmojnë në zhvillimin dhe përmirësimin e metodave didaktike të përdorura.</p> <p><i>Aneksi Nr.14, Rregullore e programit të studimit në Bachelor në "Informatikë Ekonomike"- Anglisht</i></p> <p><i>Aneksi Nr.25 dhe 26, Plani mësimor i programit studimor.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.34, CV e personelit akademik të programit.</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 16 Lista e stafit akademik të programit</i></p> <p><i>Takimi me Dekanin dhe Përgjegjësin e deprtamentit.</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar</p>	<p>FE UMT ka si pjesë të strategjisë përmirësimin e kurrikulës dhe përfshirjen e studenteve në këtë proces. Për këtë qëllim shërben pyetëtori i studentëve që zhvillohet në fund të çdo semestri duke ruajtur anonimatin e tyre, si dhe fokus grupeve me studentët dhe përmes opinionëve e mendimeve që ata shprehin në mbledhjet e hapura të departamentit.</p> <p><i>Megjithatë procesi se si integrohen këto rezultate në kurrikulat e programit nuk është e qartë. Një analizë e rezultateve të përmbledhura të këtyre vlerësimeve i vihet në dispozicion personelit akademik të interesuar dhe autoritetet drejtuese nga</i></p>

<p>mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>ana e NJSBC-së me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së tyre në të ardhmen.</p> <p><i>GVJ sugjeron që të përfshihen rezultate edhe për studentët e këtij programi studimi, pasi raporti është bazuar në dokumentacionin për vitin akademik 2020-2021.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.3, Rregullore e UMT.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.11, Rregullore e FE-UMT.</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 14, Rregullore e programit të studimit në Bachelor në "Informatikë Ekonomike"- Anglisht</i></p> <p><i>Aneksi Nr.80, Model i pyetësorit të studentit per lenden pedagogun.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.88, Raportet e NJSBC për vlersimin e procesit mësimor 2020-2021.</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>UMT ka ngritur struktura në nivel institucional dhe fakulteti për të promovuar dhe përmirësuar cilësinë e mësimdhënies. Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamentet, dorëzojnë në Rektorat çdo fund viti akademik, një raport vjetor, i konceptuar si një model i vlerësimit të brendshëm të njësisë. Ky raport shërben për të patur një pasqyrë të fakultetit dhe për t'u përmirësuar në vazhdimësi.</p> <p>Në nivel institucional, për monitorimin e procesit të mësimdhënies një funksion të rëndësishëm ka dhe "Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë" (NJSBC) e cila ndër detyrat e shumta që mban, ka si detyrë edhe monitorimin e procesit mësimor dhe mbledhjen e të dhënave të studentëve mbi procesin e mësimdhënies. Kjo njësi analizon të dhënat e mbledhura dhe i shpërndan ato tek përgjigjësi përkatës i njësisë bazë. Më pas drejtuesi i njësisë bazë ka për detyrim të shpërndaj informacionin e marrë nga pyetësorët dhe ta diskutoj atë me lektorin përkatës. Gjithashtu kjo drejtori ka një rol të rëndësishëm në analizimin e ndryshimeve ligjore dhe përshtatjen e tyre me planet mësimore të ofruara nga UMT. Planet mësimore për hapjen e programeve të reja, apo për ndryshimet në programet ekzistuese kontrollohen nga NJSBC për pjesën ligjore dhe për përshtatjen e tyre me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi. Gjatë takimit me NJSBC u vu në dukje se kjo njësi nuk ndërhyr në cilësinë apo në planifikimin e planit mësimor, pasi kjo është kompetencë e plotë e njësisë bazë.</p> <p>Njësia kryesore Fakulteti i Ekonomisë, dhe njësia bazë Departamenti i Informatikës Ekonomike, duke u mbështetur në</p>

	<p>kontrollin e vazhdueshëm dhe masave të marra, të leksioneve të hapura të organizuara, si dhe të analizës së vazhdueshme të punës mësimore dhe kërkimit shkencor, krijon frymën e përgjegjësisë individuale të personelit akademik për rritjen e cilësisë së mësimdhënies në këtë program studimi. Dekani si drejtues i fakultetit mbikqyr mbarvajtjen e veprimtarisë mësimore dhe shkencore në njësinë bazë, duke koordinuar dhe bashkëpunuar me drejtuesin e njësisë bazë. Përgjegjësi i Departamentit të Informatikës Ekonomike, drejton dhe kontrollon punën mësimore, nxit dhe motivon stafin akademik për përmbushjen e procesit mësimor, realizimit të detyrave dhe kërkimin shkencor (Rregullore FE UMT, Neni 13).</p> <p>Gjatë takimit me përgjegjës të njësisë bazë dhe anëtarët e departamentit, GVJ ju vu në dukje se përgjegjësi luan një rol të rëndësishëm në motivimin e stafit, kontrollin e punës mësimore, kontrollin e syllabuseve dhe nxitjen e stafit për pjesëmarrje në konferenca dhe botime shkencore.</p> <p><i>Aneksi Nr.6, Raport vjetor i aktiviteti mësimor, kërkimor dhe shkencor- FE Viti 2022-2023.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.88, Raportet e NJSBC për vlerësimin e procesit mësimor 2020-2021.</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 35 Përmirësim i kurrikulës</i></p> <p><i>Takimi me përfaqësues të NJSBC</i></p>								
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se procesi i mësimdhënies në institucion është në harmonizimin e formatit tradicional me praktikat profesionale dhe përdorimin e mjeteve didaktike të përshtatshme. Përpjekjet e strukturave institucionale dhe fakultetit për monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies tregojnë një angazhim të vazhdueshëm për cilësi më të lartë në arsim.</i></p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="603 1512 774 1601"></th> <th data-bbox="774 1512 949 1601">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="949 1512 1125 1601">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1125 1512 1332 1601">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="603 1601 774 1641"></td> <td data-bbox="774 1601 949 1641"></td> <td data-bbox="949 1601 1125 1641"></td> <td data-bbox="1125 1601 1332 1641" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve




<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>GVJ konstatoi nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe nga vizita në UMT, se institucioni përdor metoda të efektshme të vlerësimit të dijeve të studentëve, për realizimin e qëllimeve dhe objektivave, me fokus parësor aftësimin e tyre. Konkretisht, në përputhje me parashikimet në syllabuse, metodat e vlerësimit përfshijnë testimet, detyra kursi dhe provime përfundimtare. Format e kriteret e vlerësimit të dijeve për studentët janë të përcaktuara në Rregulloren e Fakultetit dhe në Rregulloren e Programit të studimit. Kontrolli i njohurive të studentëve sipas rregullores së UMT realizohet nëpërmjet: angazhimit në diskutime gjatë leksioneve e seminareve, por edhe në formë kolegjumesh dhe detyrash të kontrolluara përgjatë zhvillimit të lëndës; detyrave të kursit që lidhen me problematikën e disiplinës; provimit të ndërmjetëm dhe përfundimtar mbi bazën e materialeve të trajtuara përgjatë zhvillimit të lëndës. Sistemi i vlerësimit të studentëve është i njëjtë për të gjitha programet me karakter profesional dhe programet e studimit të ofruar në UMT dhe realizohet nëpërmjet sistemit të vlerësimit nga nota 1 deri në 10, ku nota 5 rezulton si notë kaluese. Kontrolli i dijeve të studentëve bëhet sipas kriterëve të përcaktuara ku:</p> <ul style="list-style-type: none"> • ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive së bashku me plotësimin e detyrimeve (detyrave të kursit) - 10%, • detyrimet e lëndës (laboratore ose detyra kursi)- 20% • testimet gjatë vitit (ose provimi ndërmjetëm) - 10% • provimi përfundimtar - 60%. <p>Mënyra e vlerësimit dhe kriteret i bëhen me dije studentëve, që në fillim të vitit akademik dhe janë pjesë përbërëse e syllabuseve të lëndëve.</p> <p><i>Aneksi Nr.14, Rregullore e programit të studimit në Bachelor në "Informatikë Ekonomike"- Anglisht</i></p> <p><i>Aneksi Nr.25 dhe 26, Plan programet e lëndëve</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 27 Syllabuset.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.37, Rregullore e provimeve.</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 51 Tabelat, tabela 15</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive,</p>	<p>Gjatë takimeve në institucion me stafin akademik dhe studentët u komunikua se në fillim të lëndës në çdo semester, pedagogu i lëndës i njeh studentët me syllabusin e lëndës, në të cilin përcaktohen në mënyrë të detajuar emërimi dhe kreditet e lëndës, pedagogu i lëndës, vit/ semestri kur zhvillohet lënda,</p>

<p>dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>vendi që zë lënda në formimin e studentit, ngarkesa e orëve në auditor dhe jashtë tij, literatura e detyruar, si edhe mënyra e kontrollit dhe format e vlerësimit të dijeve, së bashku me afatet kur duhet të plotësohet secili detyrim deri në përfundim të zhvillimit të lëndës.</p> <p><i>Takimet në institucion me stafin dhe studentët</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Bazuar në rregulloret e UMT-së, Rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë, rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar edhe format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të njohurive që ka përvetsuar studenti gjatë zhvillimit teorik e praktik të lëndës/modulit si aktivizim në mësim, si testimi i ndërmjetëm/detyrat e kontrollit, detyrat e kursit dhe provimi final, për të testuar sa më realisht njohuritë dhe kompetencat e studentëve.</p> <p><i>Aneksi Nr.3, Rregullore e UMT- kreu V-Vlerësimi I dijeve</i> <i>Aneksi Nr.11, Rregullore e FE-UMT- neni 59-67.</i> <i>Aneksi Nr.14, Rregullore e programit të studimit në Bachelor në "Informatikë Ekonomike"- Anglisht</i> <i>Aneksi Nr.25 dhe 26, Plani mësimor</i> <i>Aneksi Nr. 27 Syllabuset.</i> <i>Aneksi Nr. 51 Tabelat, tabela 15</i></p>
<p>Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>FE UMT ka si pjesë të strategjisë përmirësimin e kurrikulës dhe përfshirjen e studenteve në këtë proces. Për këtë qëllim shërben pyetësi i studentëve që zhvillohet në fund të çdo semestri duke ruajtur anonimin e tyre, si dhe fokus grupeve me studentët dhe përmes opinioneve e mendimeve që ata shprehin në mbledhjet e hapura të departamentit. Megjithatë procesi se si integrohen këto rezultate në kurrikulat e programit nuk është e qartë. Një analizë e rezultateve të përmbledhura të këtyre vlerësimeve i vihet në dispozicion personelit akademik të interesuar dhe autoritetet drejtuese nga ana e NJSBC-së me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së tyre në të ardhmen.</p> <p><i>Aneksi Nr.3, Rregullore e UMT</i> <i>Aneksi Nr.11, Rregullore e FE-UMT</i></p>

	<p><i>Aneksi Nr.80, Model i pyetësorit të studentit per lenden pedagogun.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.88, Raportet e NJSBC për vlersimin e procesit mësimor 2020-2021.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Zhvillimi i orëve mësimore bëhet nëpërmjet metoda interaktive dhe diskutime, për të nxitur mendimin kritik të studentit dhe dialogun me ekspertë të ftuar në auditor apo edhe nëpërmjet platformave online për ta bërë mësimdhënien më tërheqëse dhe efektive. Personeli akademik gjatë leksioneve dhe seminareve alternon metoda të ndryshme të mesimdhënies për ti dhënë mundësinë studenteve që të marrin pjesë në diskutime, të bëjnë analiza dhe të prezantojnë ato në mënyrë bindëse dhe të argumentuar. Në orët mësimore ofrohen për diskutim edhe shembuj dhe situata konkrete me qëllim që studentët të kenë mundësinë të reflektojnë nëpërmjet aplikimit direkt kompetencat e zhvilluara si edhe të reflektojë progresin e arritur në asimilin e programit. Marrëdhënia mes pedagogeve dhe studentëve zhvillohet në respekt të rregullave të komunikimit dhe etikës institucionale.</p> <p><i>Aneksi Nr.25 dhe 26, Plani mësimor</i></p> <p><i>Aneksi Nr.14, Rregullore e programit të studimit në Bachelor në "Informatikë Ekonomike"- Anglisht</i></p> <p><i>Takim me stafin akademik dhe me studentët e programit të studimit.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Gjatë vlerësimit të dokumentacionit dhe vizitave në UMT, GVJ konstatoi përdorimin e metoda të efektshme për vlerësimin e dijeve të studentëve, duke u përqendruar kryesisht në aftësimin e tyre. Metodat e përdorura për vlerësim përfshijnë teste, detyra kursi dhe provime përfundimtare, të përcaktuara sipas rregullores së Fakultetit dhe Programit të Studimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive të studentëve realizohet nëpërmjet një kontrolli të vazhdueshëm të shprehura si përqindje (0-100%) e notës përfundimtare. Niveli i të nxënit vlerësohet përmes detyrave me shkrim dhe /ose me gojë duke përfshirë angazhimin në diskutime gjatë orëve mësimore. Kështu në këtë program studimi, aktivizimi gjatë leksioneve dhe seminareve vlerësohet me 10% të vlerësimit total, detyrat e kursit me 20% të vlerësimit, provimi i ndërmjetëm 10% të vlerësimit si dhe ai përfundimtar 60% e vlerësimit.</p> <p>GVJ mendon që shpërndarja e ngarkesës dhe vlerësimit gjatë gjithë vitit e mban studentin të angazhuar në mënyrë më efikase. Provimin final realizohet me shkrim sipas rregulloreve të UMT, të programit të studimit etj.</p> <p><i>Aneksi Nr.3, Rregullore e UMT- kreu V-Vlerësimi I dijeve</i> <i>Aneksi Nr.11, Rregullore e FE-UMT- neni 59-67.</i> <i>Aneksi Nr.14, Rregullore e programit të studimit në Bachelor në "Informatikë Ekonomike"- Anglisht</i> <i>Aneksi Nr.25 dhe 26, Plani mësimor</i> <i>Aneksi Nr. 27 Syllabuset.</i> <i>Aneksi Nr. 51 Tabelat, tabela 15</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Testimi i njohurive me shkrim bëhet me anë të sekretimit (sistemi barcode), proces i cili realizohet nën mbikqyrjen e sekretarisë mësimore, dhe garanton anonimatit dhe eliminon format e ndryshme të abuzimit duke rritur transparencën.</p> <p><i>Aneksi Nr.37, Rregullore e provimeve.</i></p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Për vlerësimin e provimeve angazhohen të paktën 2 anëtarë që drejtohen nga titullari i lëndës. Tezat e provimit hartohet nga pedagogu i lëndës, nënshkruhen nga përgjegjësi i departamentit dhe ndryshohen rregullisht duke patur si qëllim që të vlerësojnë njohuritë e studentëve. Studentët merren në provim nga një komision i përbërë nga dy pedagogë të lëndës, nga titullari i lëndës, i cili është përgjegjës dhe ndjek zhvillimin e provimit.</p> <p><i>Aneksi Nr.3, Rregullore e UMT- kreu V-Vlerësimi I dijeve</i> <i>Aneksi Nr.11, Rregullore e FE-UMT- neni 59-67.</i></p>

	<p><i>Aneksi Nr.14, Rregullore e programit të studimit në Bachelor në "Informatikë Ekonomike"- Anglisht</i></p> <p><i>Aneksi Nr.37, Rregullore e provimeve.</i></p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët, GVJ u informua që ata orientohen që në fillim të lëndës nga pedagogët në lidhje me programin e lëndës dhe detyrimeve të saj, me testimet e ndërmjetme, me pikët që i korespondojnë atyre, me strukturën e detyrave e projekteve të kursit. Në vazhdim ata instruktohen me mënyrën se si do të realizojnë detyrën e kursit apo projektit, i cili në fund të lëndës apo modulit prezantohet nga studentët para kursit të tyre dhe pedagogut të lëndës (kjo bëhet në forma të ndryshme sipas rastit në ppt, foto, video, në orët e fundit të seminareve).</p> <p>Një procedurë e tillë mundëson marrjen e feedback-ut si nga pedagogu ashtu dhe nga studentët e tjerë në lidhje me aspektet pozitive të punimit apo elementët që kanë nevojë për përmirësim apo detajim të mëtejshëm. Ky proces ballafaqimi me një audiencë të caktuar ndihmon studentët të përmirësohen në drejtim të mësimnxënies si dhe të fitojnë/ përmirësojnë aftësitë e tyre prezantuese.</p> <p><i>Aneksi Nr.3, Rregullore e UMT- kreu V-Vlerësimi I dijeve</i></p> <p><i>Aneksi Nr.11, Rregullore e FE-UMT- neni 59-67.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.14, Rregullore e programit të studimit në Bachelor në "Informatikë Ekonomike"- Anglisht Kreu V-Vlerësimi I studentit</i></p> <p><i>Aneksi Nr.25 dhe 26, Plani mësimor</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 27 Syllabuset.</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Në rregulloren e UMT janë të paraqitura rregullat e zhvillimit të provimit. UMT nuk lejon kopjimin por gjithashtu edhe në përgatitjen e detyrave të kursit por sidomos të punimit të diplomës nuk lejohet plagjiatura. Gjatë takimit me stafin, disa prej tyre kishin akses individual në platforma ndërkombëtare të kontrollit.</p> <p><i>GVJ sugjeron institucionalizimin e këtyre platformave për të gjithë anëtarët e stafit në mënyrë që të rritet efikasiteti dhe transparenca në zbatimin e rregullave të parandalimit të plagjiaturës.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.3, Rregullore e UMT</i></p>




	<i>Aneksi Nr.37 Rregullore e provimeve</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	<p>Vlerësimi i dijeve dhe njohurive të fituara nga studentët e këtij programi bëhet në zbatim të Rregullores së Përgjithshme të UMT, FE dhe rregullores së programit të studimit. Pedagogu vlerëson me pikë secilin komponent të tezës. Pas korrigjimit provimet dorëzohen brenda 3 ditëve në sekretarinë mësimore së bashku me procesverbalet përkatëse. Notat i jepen studentit nga sekretaria mësimore ose nëpërmjet aksesit online. Vlerësimi për komponentët e tjerë i dorëzohet studentit përpara zhvillimit të provimit përfundimtar, dhe pedagogu nuk ka të drejtë të ndërhyjë për ndryshimin e tyre pas zbardhjes së rezultateve të provimeve.</p> <p><i>Aneksi Nr.3, Rregullore e UMT - kreu V-Vlerësimi I dijeve</i> <i>Aneksi Nr.11, Rregullore e FE-UMT - neni 59-67.</i> <i>Aneksi Nr.37, Rregullore e provimeve</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> <p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Studenti ka të drejtë që të ankohet për vlerësimin e provimit dhe ankesa i paraqitet me shkrim pedagogut të lëndës dhe komisionit të provimit, i cili nëse verifikon shkelje të korrigjueshme ndërmerr hapat e nevojshëm së bashku me komisionin e provimit.</p> <p>Në rast se studenti nuk është i bindur për vlerësimin korrekt nga ana e pedagogut, atëherë ankohet me shkrim pranë Përgjegjësit të Departamentit dhe kur e gjen të pamundur zgjidhjen e problemit e përcjell tek dekani. Dekanin ngre një komision ad-hoc për verifikimin e pretendimeve të studentit dhe përcakton vlerësimin përfundimtar. Vlerësimi i Komisionit që ngrihet është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi i kontestuar. Procesverbalet e vlerësimit firmosen dhe dorëzohen në Sekretarinë Mësimore.</p> <p><i>Aneksi Nr.3, Rregullore e UMT- kreu V-Vlerësimi i dijeve</i> <i>Aneksi Nr.11, Rregullore e FE-UMT - neni 59-67.</i> <i>Aneksi Nr.37, Rregullore e provimeve</i></p>
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se FE-UMT siguron një vlerësim të drejtë dhe transparent të studentëve përmes një sistemi të strukturuar të vlerësimit, i bazuar në meritë dhe me sigurimin e anonimitetit gjatë provimeve për të parandaluar plagjiaturën. Përveç kësaj, ofrohet orientim dhe komunikim i qartë me studentët për të garantuar një mjedis të drejtë dhe të barabartë për të gjithë.</i>

	<i>GVJ rekomandon përshtatjen e një platforme për parandalimin e plagjiaturës në mënyrë institucionale.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	<p>Programi i studimit në Informatikë Ekonomike në gjuhën angleze siguron thellimin e njohurive duke ofruar një gamë të gjerë të temave të lidhura me teknologjitë kompjuterike dhe aplikimet e tyre në fushën e biznesit. Për të arritur këtë, programi trajton analizat e kërkesave të informacionit të biznesit, zhvillimin e aplikacioneve të ndryshme duke përdorur gjuhë programimi të avancuara, si dhe njohuritë e nevojshme për menaxhimin dhe përpunimin e të dhënave.</p> <p><i>Aneksi Nr.14, Rregullore e programit të studimit në Bachelor në "Informatikë Ekonomike"- Anglisht</i></p> <p><i>Aneksi Nr.26, Plani mësimor sipas llojit të veprimtarisë.</i></p> <p><i>Web page: https://umt.edu.al/business-informatics/</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit GVJ konstatoi se modulet/lëndët janë në përputhje me zbatimin e VKM 41/2018 të ndara në lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrimeve përmbyllëse.</p> <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni si edhe në takimin me studentët dhe lektorët e këtij programi studimi, programi garanton një sërë njohurish të përshtatshme për tregun e punës. Programi ndihmon në zhvillimin e aftësive profesionale të studentëve duke i përgatitur ata për të përballuar sfidat e tregut të punës në sektorin e teknologjisë së informacionit. Studentët pajisen me aftësitë e nevojshme për të ofruar shërbime IT-ekonomike, për të menaxhuar teknologjinë dhe shërbimet ekonomike, si dhe për të punuar në sektorin publik ose privat në rolet e ndryshme të ekonomisë dhe IT-së.</p>

	<p><i>Aneksi Nr.14, Rregullore e programit të studimit në Bachelor në "Informatikë Ekonomike"- Anglisht</i></p> <p><i>Aneksi Nr.26, Plani mësimor sipas llojit të veprimtarisë</i></p> <p><i>Web page: https://umt.edu.al/business-informatics/</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Si rregull, në përfundim të lëndës pedagogu bën një përmbledhje të koncepteve dhe çështjeve kryesore të zhvilluara, duke përfshirë në diskutim edhe studentët dhe duke marrë mendimin e tyre për çfarë mund të përmirësohet në vijim. Gjithashtu eseja apo detyra e kursit që zhvillohen janë një formë e shqyrtimit të aftësive që kanë përfituar studentët nga lënda</p> <p><i>Aneksi Nr. 27 Syllabuset.</i></p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>GVJ konstatoi se përbërja e kurrikulës së programit të studimit, lëndët dhe modulet që e përbëjnë atë, janë të ndërtuara në mënyrë të tillë që t'i pajisin studentët me aftësi për t'ju përgjigjur kërkesave të tregut të punës. Kurikula e programit të studimit përmban zhvillimin e praktikës mësimore në vitin e tretë. Hartimi i planit mësimor është bërë në mënyrë të tillë që t'i japë hapësirë studentit për të zhvilluar praktikën profesionale. Ky organizim i kurrikulës u jep mundësinë studentëve për t'i zhvilluar më tej aftësitë dhe kompetencat e fituara në trajtimet e programit të studimit në praktikë. Institucioni përfshin studentët e këtij programi studimi në mobilitet të ndryshme ndërkombëtare.</p> <p><i>Për të thelluar dimensionin ndërkombëtar të programit <u>GVJ sugjeron një qasje më të madhe të profesorëve dhe studentëve në universitet ndërkombëtarë.</u></i></p> <p><i>Aneksi Nr.14, Rregullore e programit të studimit në Bachelor në "Informatikë Ekonomike"- Anglisht</i></p> <p><i>Aneksi Nr.25, Plani mësimor</i></p> <p><i>Aneksi Nr.22, Programi i praktikës</i></p> <p><i>Aneksi Nr.23, Lista e shkëmbimeve nderkombetare të studentëve</i></p>

<p>Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Stafi akademik zhvillon seminare dhe leksione të hapura jashtë orarit mësimor me lektorë apo ekspertë të ftuar me qëllim që të informojë kolegët dhe studentët e interesuar mbi zhvillimet më të fundit sipas fushave të tyre të studimit. Sikurse u përmend dhe më sipër institucioni përdor kryesisht mobilitetet për kualifikimin e mëtejshëm të stafit, por gjithashtu konfirmuar edhe nga intervista me stafin organizohen edhe trajnime specifike. Kualifikimi I vazhdueshëm në fushën profesionale dhe atë të mësimdhënies, sikurse edhe kërkimi shkencor janë pjesë e Planit të Strategjisë UMT.</p> <p><i>Aneksi Nr.04, Strategjia e zhvillimit të UMT, viti 2019</i></p> <p><i>Aneksi Nr.19, Lista e shkëmbimeve nderkombetare</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstatoi se programi i studimit në Informatikë Ekonomike ofron një kombinim të thellë të njohurive akademike dhe aftësive praktike për të përgatitur studentët për tregun e punës.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.5</p>	
<p>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>Programi i studimit përfundon me Mbrojtjen e Temës së Diplomës një provim publik përpara një komisioni, i cili përbëhet nga dy pedagogë dhe ngrihet për këtë qëllim. Studentët duhet të kenë përfunduar me sukses të gjitha lëndët e kërkua dhe dorëzimin e tezës në mënyrë që të kualifikohen për mbrojtjen e temës. Teza është një projekt studimor individual i studentit në fushat e specializimit të tij.</p> <p><i>Aneksi Nr.3, Rregullore e UMT.</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 37, Rregullore e provimeve</i></p> <p><i>Aneksi Nr.49. Procedurat e përgatitjes dhe mbrojtjes së diplomës</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli</p>	<p>Studenti udhëhiqet gjatë periudhës së përgatitjes së tezës nga pedagogë me ekspertizë në fushën e specializimit. Për</p>

<p>akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>përgatitjen e tezës studentit i ofrohet edhe një ndihmë e specializuar nëpërmjet një udhëzuesi, i cili ofron të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me procedurat dhe hapat që duhen ndjekur nga studentët për zhvillimin e tezës. Studenti asistohet edhe përmes takimeve të tjera me pedagogun udhëheqës dhe komunikimit përmes e-mailit dhe platformave të tjera elektronike, që janë në dispozicion të studentit dhe pedagogut udhëheqës.</p> <p><i>Aneksi Nr.3, Rregullore e UMT.</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 41, Modeli I diplomes</i></p> <p><i>Aneksi Nr.49. Procedurat e përgatitjes dhe mbrojtjes së diplomës</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Sipas rregullores së programit të studimit studentët në përfundim të ciklit të parë të studimeve në programin Bachelor në Informatikë Ekonomike në aglisht mund të mbrojnë temë diplome ose të zhvillojnë provim formimi në bazë të mesatares. Praktika të tyre ende nuk ka, duke qenë se është brezi i parë i studentëve që diplomohen.</p> <p><i>Aneksi Nr.14, Rregullore e programit të studimit në Bachelor në "Informatikë Ekonomike"- Anglisht, Kreku V, 27</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Udhëheqësit e temave të diplomës janë personel akademik efektiv i UMT i profilizuar në fushën përkatëse. Përzgjedhja e temave bëhet nga studentët në bazë të temave që paraqesin ata ose pedagogët e programit. Udhëheqja e studentit bëhet nga udhëheqësi i tezës i miratur nga departamenti në bazë të dispozitave në fuqi. Kërkesa për të propozuar temat dhe pedagogun udhëheqës bëhet pranë departamenti.</p> <p><i>Aneksi Nr.14, Rregullore e programit të studimit në Bachelor në "Informatikë Ekonomike"- Anglisht</i></p> <p><i>Aneksi Nr.49. Procedurat e përgatitjes dhe mbrojtjes së diplomës</i></p> <p><i>Takimi me stafin dhe studentet</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për</p>	<p>Në përgatitjen e temës së diplomës studentët ndihmohen nga stafi i programit për realizimin e detyrimeve akademike ose</p>

<p>kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>kërkimore, hedhjen e të dhënave grafike apo statistikore, përpunimin e pyetësorëve apo anketave duke përdorur të gjithë infrastrukturën e bibliotekave, sallave të kompjuterave por edhe duke shfrytëzuar bazën kërkimore të institucioneve të tjera me të cilat programi ka marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p><i>Aneksi Nr.14, Rregullore e programit të studimit në Bachelor në "Informatikë Ekonomike"- Anglisht</i></p> <p><i>Aneksi Nr.49. Procedurat e përgatitjes dhe mbrojtjes së diplomës, Financë</i></p> <p><i>Takimi me stafin dhe studentet</i></p> <p><i>Vizita ne IAL, sallat e kompjuterave</i></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Për vlerësimin (notën) e tezës së bachelor-it vendos komisioni i ngritur për këtë qëllim. Anëtarët e komisionit vendosin notën për studentin dhe firmosin në procesverbalin e vlerësimit të mbrojtjes së diplomës.</p> <p><i>Aneksi Nr. 37, Rregullore e provimeve</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të përbushjes së të gjitha detyrimeve akademike, studenti pajiset me diplomën Bachelor në "Informatikë Ekonomike" dhe suplementin e saj, sipas formatit të miratur nga MASR dhe i firmosur nga Dekani i FE dhe Rektori i UMT. Në këtë dokument specifikohet gjuha e zhvillimit të mësimit që është ajo anglisht. Në përfundim të programit, me kërkesën e tij, studentit i vihet në dispozicion një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p> <p><i>Aneksi Nr.42, Suplement diplome-Bachelor ne Informatik Ekonomike</i></p> <p><i>Aneksi Nr.14, Rregullore e programit të studimit në Bachelor në "Informatikë Ekonomike"- Anglisht</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Pas përfundimit të studimeve, kopje e dokumentacionit të studentit të regjistruar arkivohet dhe ruhet për një periudhë pa afat. Në përbushje me detyrimet institucionale, informacioni i paraqitet palëve të interesuara në përputhje me normativat ligjore për ruajtjen e të dhënave personale. Institucioni disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve, dhe përpunon të dhëna statistikore sipas kërkesave të institucioneve përgjegjëse apo nevojave të vetë institucionit.</p>




	<p><i>Aneksi Nr.40, Rregullore e Sekretarisë.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.43, Rregullore e arkives.</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmblyëse të studentit në programin e studimit. Ai duhet të përgatisë dokumentacionin përkatës të këtij programi studimi si Suplementi dhe Procedurat e përgatitjes dhe mbrojtjes së diplomës.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën	Nga takimi i GVJ me përgjegjës të Departamentit të Informatikës Ekonomike, përgjegjës për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor “Informatikë Ekonomike”, u vendos theksi që, UMT ndjek një politikë të qartë në drejtim të rekrutimit të stafit akademik. Synim i së cilës është tërheqja e stafit të kualifikuar me grada e tituj shkencor (mund të punësohen edhe pedagogë që nuk kanë tituj e grada, por që kanë një eksperiencë të gjatë e të suksesshme në profesionin dhe institucionin e tyre), me eksperiencë në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor si dhe rekrutimi i stafit administrativ me eksperiencë për pozicionin vakant. Për shkak të gjuhës Anglisht që ky program studimi ofrohet, stafi akademik përvec

kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

profesionalizmit dhe ekspertizës në fushat dhe lëndët që ata zhvillojnë, duhet ti zhvillojnë këto lëndë tërësisht në Anglisht.

Finalizimi i procedurës së punësimit përmbyllet më kontratën e punës ku evidentohen element të ngarkesës mësimore, detyrimeve dhe përgjegjësi etj. Në këtë program studimi, dhënat për stafin e angazhuar për mësimdhënie gjatë tre viteve akademike paraqiten si vijon:

Tituj/ grada	2021-2022		2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	0	0	0	0	3	1
Prof. Asoc.	1	1	0	2	3	5
Dr./PhD.	4	0	3	3	3	2
Msc.	3	1	4	4	3	6
Totali	8	2	7	9	12	14

Aneks Nr.13 - Lista e stafit.

Aneks Nr.28-Plani i ngarkeses se stafit.

Aneks Nr.16-Lista e Stafit te programi.

Aneks Nr.3 -Rregullore UMT.pdf

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Nga takimi i GVJ me Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe me stafin efektiv të Departamentit për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor “Informatikë Ekonomike” ngarkesa mësimore përcaktohet në kontratën individuale të punës. Kjo ngarkesë përcaktohet me vendim Rektorati dhe është në përputhje me kriteret e akteve nënligjore në fuqi. Personeli akademik efektiv u shpreh gjithashtu që krahas ngarkesës në auditor është i angazhuar edhe me veprimtari të tjera mbështetëse si: tutoriati, këshillim akademik, praktikat profesionale etj,

Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)
2023-2024	1825	1225	600	67.2% /32.8%

Aneks Nr.28-Plani i ngarkeses se stafit.

Aneks Nr.16-Lista e Stafit te programi.

<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Nga dokumentat e vendosura në sistem si edhe nga takimi i GVJ me Zyrën e Burimeve Njerëzore, evidentohet se personeli i UMT-së mund të jetë i punësuar me kontratë, me kohëzgjatje të pacaktuar ose të caktuar si dhe me angazhim me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme. Në të gjitha rastet UMT lidh kontratën përkatëse të punës e cila bazohet në legjislacionin në fuqi dhe përcakton të drejtat dhe detyrimet e palëve. Për tre vitet akademike, stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi thuajse është i njëjti duke dëshmuar në këtë mënyrë për një qëndrueshmëri të stafit akademik të brëndëshëm dhe administrativ të UMT.</p> <p><i>Aneks Nr.45-Model kontrata e punes.</i></p> <p><i>Aneks Nr.28-Plani i ngarkeses se stafit.</i></p> <p><i>Aneks Nr.16-Lista e Stafit te programi.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Referuar procedurës së konsultuar të rekrutimit, GVJ konstaton se Universiteti Metropolitan “Tirana”, harton dhe zbaton procedura rekrutimi, të mbështetura në vlerësimin e aplikantëve në dy faza, atë të vlerësimit të dosjes dhe atë të intervistës. Vlerësimi i dosjes rezulton se bëhet nëpërmjet vlerësimit të kritereve të përgjithëshme dhe specifike, nga komisioni i përbërë nga 5 anëtarë, me 3 përfaqësues të departamentit, 1 i dekanatit dhe 1 i rektoratit.</p> <p>GVJ mbështetur në dokumentacionin në dosjen e vetëvlerësimit, si dhe gjatë vizitës në institucion, konstaton se procedurat e rekrutimit të stafit akademik mbështeten në legjislacionin në fuqi, si dhe në statutin dhe rregulloren e institucionit. Referuar procedurës së rekrutimit të konsultuar gjatë vizitës në zyrën e Burimeve njerëzore, GVJ konstaton se Universiteti Metropolitan “Tirana”, harton kërkesa të përgjithshme, si dhe kritere preferenciale për stafin e programit.</p> <p>Nga vizita në institucion rezulton se kërkesat burojnë nga nevojat e njësisë përgjegjëse për staf akademik, ato përcillen në njësinë kryesore e në vijim në rektoratin e institucionit, së bashku me kriteret specifike, për lëndët, botimet etj. Referuar politikës së rekrutimeve, Universiteti Metropolitan “Tirana”, rezulton se institucioni publikon në faqen e internetit, thirrjet për punësim të stafit akademik efektiv dhe atyre me kohë të pjesshme, në të cilën deklarohet pozicioni vakant kriteret dhe procedura e përzgjedhjes. Në vizitën që GVJ pati në institucion, stafi i burimeve njerëzore shprehet se vëndet vakante për</p>

	<p>personel akademik apo administrativ bëhen publike në faqen Web të institucionit https://umt.edu.al/mundesipunesimi/</p> <p>Sipas tyre, ndër kandidatët për personel akademik efektiv apo të ftuar, përzgjidhen më të mirët, duke synuar jo thjesht formimin akademik por mbi të gjitha profesionalizmin, ekspertizën dhe eksperiencën në fushat përkatëse ku ata edhe do të angazhohen në mësimdhënie. Çdo Departament përcakton nevojën për staf akademik në funksion të ngarkesës dhe të planeve mësimore të lëndëve. Njësia bazë përcakton kriteret e punësimit të cilat miratohen nga Rektori. Vlerësimi i kandidatëve bëhet me konkurs nga një komision rekrutimi në bazë të përmbushjes së kriterëve të shpallura.</p> <p><i>Aneks Nr.2 - Statuti.</i></p> <p><i>Aneks Nr.3 -Rregullore UMT.</i></p> <p><i>Aneks Nr.46-Njoftim per vende vakante.</i></p> <p><i>Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Mbeshtetur në dokumentat bazë të UMT (statuti, rregullore, etj) personeli ndihmës akademik/laboratorik përzgjidhet me konkurs nga një Komision Vlersimi të kandidatëve mbështetur në kriteret e shpallura dhe të vendosura nga departamenti. Nga vizita që GVJ zhvilloi në mjediset e laboratorit e UMT për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor “Informatikë Ekonomike”, personat përgjegjës paraqesnin formim profesional me përvojë, ekspertë të fushës dhe të suksesshëm në profesionin e tyre.</p> <p><i>Aneks Nr.2 - Statuti.</i></p> <p><i>Aneks Nr.3 -Rregullore UMT.</i></p> <p><i>Aneks Nr.46-Njoftim per vende vakante.</i></p> <p><i>Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave</p>	<p>Nga takimi që GVJ pati me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore, nga kontrolli i dokumentacionit në dosjet e personelit akademik dhe administrativ të UMT u evidentua që dosja përmbante në mënyrë të përditësuar sa më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Dokument identifikimi; ▪ CV-në (sipas formatit të BE-së); ▪ Raport i aftësisë për punë/Librezë shëndetësore;

<p>personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Librezë Pune dhe Librezë Kontributesh për Sigurimin Shoqëror dhe Shëndetësor (nëse ka); ▪ Leje nga Punëdhënësi kryesor (Vetëm në rastet kur personeli akademik është i angazhuar me kohë të pjesshme në UMT) ▪ Diplomë të arsimit të lartë të kryer <p><i>Aneks Nr.45-Model kontrata e punes.</i> <i>Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Mbështetur në rregulloren e programit të studimit dhe planit mësimor, programi i studimit përmban edhe praktike (Internship) e cila zhvillohet në vitin e tretë, në semestrin e dytë prej 6 ECTS total. Stafit akademik krahas ngarkesës mesimore zhvillon sistemin e tutorazhit dhe mbikëqyrjes studentore për zhvillimin e praktikës mësimore pranë subjekteve apo bizneseve. Këto praktika rregullohen në bazë të marrëveshjeve institucionale ndërmjet UMT dhe bizneseve.</p> <p><i>Aneks Nr.14 - Rregullore programi</i> <i>Aneks Nr.25-Plani mesimor</i> <i>Aneks Nr.26 - plani mesimor</i> <i>Aneks Nr.21-Marreveshjet e bashkepunimit</i> <i>Aneks Nr.48-Dokumentacion per praktikes</i></p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Studentët duhet të kryejnë praktiktën në vitin e tretë, në semestrin e dytë, në institucione apo bizneset pritëse. Në përfundim të praktikës, personi përgjegjës në subjektin pritës I cili ka mbikqyrur studentin, duhet të shprehet për performancën e studentit gjatë periudhës së intershipit. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, GVJ nuk gjeti asnjë praktikë për raportin final në lidhje me intershipin, pasi ky është brezi i parë i studentëve që mund të kryejnë intershipin.</p> <p><i>Aneks Nr.25-Plani mesimor</i> <i>Aneks Nr.21-Marreveshjet e bashkepunimit</i> <i>Aneks Nr.48-Dokumentacion per praktikes</i></p>

Konkluzione	<i>UMT bën përpjekje të vazhdueshme për rritjen e cilësisë së mësimdhënies, trajnimit dhe stafit akademik dhe ndihmes akademik duke përzgjedhur ekspertë të fushës në përshtatje me natyrën e lëndëve që programi i studimit ofron</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	<p>GVJ duke konsultuar dokumentacionin për infrastrukturën si dhe nga vizita në mjediset e Universitetit Metropolitan “Tirana”, konstaton se Institucioni ka në dispozicion dy godina me sipërfaqe respektive, 2347 m² dhe 2490 m². Mjediset janë mjedise të përshatshme për zhvillimin e leksioneve/seminareve. Nga vizita në institucion GVJ konstatoi që mjediset (labororët dhe klasat për mësimdhënie) garantojnë një zhvillimin normal të veprimtarive mësimore. Mjediset nga pikpamja infrastrukturore dhe arkitektonike sigurojnë një mësim normal me standarte në drejtim të ndriçimit, lartësisë, kushteve të sigurisë në përputhje me numrin e studentëve të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Informatikë Ekonomike”.</p> <p><i>Aneks Nr.47-Infrastruktura FE.</i></p> <p><i>Aneks Nr.51-Asete infrastrukturore akademike.</i></p>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, labororë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit	<p>Nga RVB dhe nga vizita në institucion, sallat e leksioneve, seminareve, labororët janë të pajisura me pajisje audiovizive, PC, videoprojektor, internet wireless etj, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. Referuar vizitës në institucion, gjenden 6 labororë informatikë, 6 salla leksionesh dhe 14 salla seminaresh e etj.</p> <p><i>Aneks Nr.47-Infrastruktura FE.</i></p>

të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	<i>Aneks Nr.51-Asete infrastrukturore akademike.</i>			
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Sipas informacionit të siguruar nga dosja e vetëvlerësimit si dhe nga vizita në institucion, rezulton se laboratorët informatikë janë të pajisur me pajisjet hardwerike të duhura si dhe me softë specifike, në ndihmë të objektivave të programit Bachelor “Informatikë Ekonomike”. <i>Aneks Nr.47-Infrastruktura FE.</i> <i>Aneks Nr.51-Asete infrastrukturore akademike.</i>			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Gjatë vizitës në Institucion, GVJ evidentoi se UMT ka në dispozicion të programit të studimit 6 laboratorë të teknologjisë së informacionit me poste pune të pajisur me programe profesionale. <i>Aneks Nr.47-Infrastruktura FE.</i> <i>Aneks Nr.51-Asete infrastrukturore akademike.</i> <i>Aneks Nr.52-Manuale përdorimi të Sistemit informatik.</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike. Infrastruktura është e përshtatshme dhe pajisur me salla leksioni dhe seminari, laboratore dhe bibliotekë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjediset e posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në RVB si dhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni si edhe gjatë vizitës në bibliotekën e institucionit, GVJ konstatoi një fond librash fizike, periodike, revista në anglisht për fushën e ekonomisë dhe informatikës. Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se në bibliotekë disponohet literatura e mjaftueshme që ndihmon studentin në përvetësimin e dijeve sipas programit dhe lëndëve mësimore përkatëse. Biblioteka ka vënde leximi dhe kompjutera për punime dhe kërkime shkencore. Gjithashtu në çdo syllabus të secilës prej lëndëve përcaktohet literatura e detyrueshme dhe ajo e rekomanduar, në Anglisht.</p> <p><i>Aneks Nr.53-Rregullore e bibliotekes.</i> <i>Aneks Nr.54-Inventari i teksteve ne FE.</i> <i>Aneks Nr.27.1 SilabusetV1.</i> <i>Aneks Nr.27.2 SilabusetV2.</i> <i>Aneks Nr.27.3 SilabusetV3.</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësim të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga Institucioni, GVJ evidenton se literatura e detyrueshme dhe ajo ndihmëse është e viteve të fundit. Gjatë takimit që GVJ pati me stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi, sikurse edhe me përgjegjësin e departamentit përgjegjës për këtë program studimi, u theksua fakti që rishikimi i syllabuseve bëhej para fillimit të vitit akademik. Një nga elementët e rishikimit të syllabuseve është edhe përditësimi i literaturës bazë dhe mbështetëse me botime të viteve të fundit.</p> <p><i>Aneks Nr.27.1 SilabusetV1.</i> <i>Aneks Nr.27.2 SilabusetV2.</i> <i>Aneks Nr.27.3 SilabusetV3.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion, konstaton se UMT, vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore e cila është ka një fond librash, në gjuhë shqipe dhe të huaj, periodikë, revista shkencore etj. Për realizimin normal të të gjithë procesit mësimor, Institucioni vë në dispozicion të studentëve pa pagesë bibliotekën mësimore, në mënyrë që të sigurojë pjesëmarrje të gjerë të studentëve dhe mundësi të barabartë për të gjithë studentët. Biblioteka mund të përdoret nga studentët pa kufizime gjatë orarit zyrtar që biblioteka qëndron e hapur.</p>




	<p>Gjatë vizitës në institucion, evidentoi se <i>biblioteka nuk disponon vënde të mjaftueshme për studentët dhe nuk ka shumë mundësi për të studjuar në të, si dhe për të përdorur kompjuterat që biblioteka disponon.</i></p> <p><i>Aneks Nr.54-Inventari i teksteve ne FE.</i></p> <p><i>Aneks Nr.27.1 SilabusetV1.</i></p> <p><i>Aneks Nr.27.2 SilabusetV2.</i></p> <p><i>Aneks Nr.27.3 SilabusetV3.</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.</p>	<p>GVJ u informua se biblioteka e institucionit ka tituj në gjuhën shqipe, tituj në gjuhë të huaj si edhe materiale periodikë. Referuar RVB si dhe vizitës në institucion, biblioteka rezultoi të këtë libra në gjuhë shqipe dhe të huaj, revista shkencore, literaturë bazë dhe ndihmëse sipas syllabuseve të lëndëve të programit të studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike”. Të gjithë titujt e bibliotekës përditësohen rregullisht në databazën e Bibliotekës dhe çdokush, në çdo kohë mund të ketë akses tek titujt që janë gjendje.</p> <p><i>Aneks Nr.54-Inventari i teksteve ne FE.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka akses në bibliotekën digjitale. UMT ofron libraritë e sugjeruara on-line nga biblioteka ku institucioni është abonuar të tilla si JSTOR. Biblioteka dixhitale ofron një mori artikuj të revistave akademike, libra si edhe dokumente në një sërë disiplinash. Biblioteka online është e aksesueshme falas nga studentët dhe stafi akademik. Nga RVB dhe nga takimet me studentët e programit, rezultojnë se ata kanë mundësinë e shfrytëzimit të bibliotekës, të fondit të saj fizik por ata kanë akses edhe në disa biblioteka elektronike, të shfrytëzueshme jo vetëm në mjediset e institucionit por edhe jashtë tij, nëpërmjet kredencialeve të studentëve.</p> <p>www.doaj.org</p> <p>www.cobis.org</p> <p>www.gutenberg.org</p>

<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Biblioteka rezulton e pajisur me kompjutera me softere respektive për manaxhimin e bazës së të dhënave të bibliotekës si dhe me pajisje të tjera si fotokopje e pajisje skanuese.</p> <p>Hapësira fizike dhe kapacitet pritëse të bibliotekës konsiderohen të limituara nga GVJ. Edhe pse një mjedis që fton studentët dhe një klimë e mirë aktuale, <i>GVJ do të sugjeronte shtimin e kapaciteteve fizike, posteve dhe pc-ve në bibliotekën e UMT, pavarësisht se institucioni ka në planet e veta zgjerimin e kapaciteteve në kuadër të investimit në kampusin e ri të institucionit në të ardhmen.</i></p> <p><i>Aneks Nr.53-Rregullore e bibliotekes.</i></p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>GVJ konstaton se biblioteka funksionon në orare në përshtatje me nevojën për shfrytëzim nga ana e studentëve të Bachelor në “Informatikë Ekonomike” – Anglisht të tilla si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Huazim i librave/teksteve. Studentët mund të regjistrohen duke paraqitur një vërtetim studenti, fotokopje të kartës së identitetit dhe një foto; - Sallë studimi; - Hapësirë për kryerjen e detyrave apo projekteve në grup. <p>Studentët kanë mundësi të shfrytëzojnë edhe bibliotekat elektronike, në të cilat UMT rezulton i regjistruar, duke rritur fleksibilitetin e përdorimit të bibliotekës si www.doaj.org, www.cobis.org, www.gutenberg.org</p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë</p>	<p>Gjatë vizitës në bibliotekë GVJ u informua se shtimi i zërave të bibliotekës bëhet mbi bazën e kërkesave të bëra nga Departamentet duke u bazuar në buxhetin e institucionit. Gjithashtu, Institucioni, ka pasuruar edhe bibliotekën online duke qenë pjesë e një sërë platformave online.</p> <p><i>Aneks Nr.54-Inventari i teksteve ne FE.</i></p>




qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.									
Konkluzione	<i>Biblioteka e institucionit ka tituj në gjuhën shqipe, tituj në gjuhë të huaj si edhe materiale periodikë. Biblioteka dixhitale ofron një mori artikuj të revistave akademike, libra si edhe dokumente në një sërë disiplinash. Biblioteka online është e aksesueshme falas nga studentët dhe stafi akademik. GVJ do të sugjeronte shtimin e kapaciteteve fizike, posteve dhe pc-ve në bibliotekën e UMT, pavarësisht se institucioni ka në planet e veta zgjerimin e kapaciteteve në kuadër të investimit në kampusin e ri të institucionit në të ardhmen.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Përveç formave manuale, GVJ konstatoi një sistem informacioni funksional, që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, i cili është pjesë e një sistemi të integruar informacioni në nivel institucional në UMT. Menaxhimi i informacionit që lidhet me aktivitetin e studentit në UMT garantohet nga Rregulloret përkatëse. Informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin mbahet nga Sekretaria Mësimore. Gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se dokumentacioni që mbahet nga kjo Sekretari dhe që disponohet është në përputhje me aktet ligjore e nënljore në fuqi. Në Sekretarinë mësimore GVJ u njoh me mbajtjen në format letër Regjistrimit të arritjeve akademike dhe Regjistrimit të diplomave si dhe me dokumentacionin e dorëzuar nga studenti në momentin e regjistrimit/transferimit. Regjistri themeltar

	<p>gjithashtu mbahej në format elektronik ashtu edhe në formë fizike në regjistrin e miratuar nga QSHA.</p> <p>Gjithashtu, aplikacioni në nivel institucioni i përdorur është ai edu4school dhe gotometting i cili përfshin gjithë modulet e sistemit të manaxhimit të informacionit të Studentëve. Sistemi mundëson komunikimin e informacionit si: mësimin, regjistrimin në kurset përkatëse, orari i sezoneve të provimit, rezultatet e mbledhjet e punës. Sekretaria mësimore nëpërmjet këtij sistemi, administron të gjithë informacionin e studentit nga regjistrimi i tij e deri në përfundim të studimeve, për detyrimet e lëndëve, vlerësimin etj. Referuar takimit të zhvilluar me stafin e burimeve njerëzore, rezulton se zyra e burimeve njerëzore administron të dhënat dhe dokumentacionin për aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrative.</p> <p><i>Aneks Nr.40-Rregullore e sekretarise</i> <i>Aneks Nr.52-Manuale përdorimi të Sistemit informatik</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> <p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ, bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion sikurse edhe nga takimi që pati në institucion, evidentoi se Institucioni mban të dhëna të cilat rinovohen çdo vit në lidhje me stafin akademik, ndihmës akademik sikurse edhe atë administrativ apo edhe marrëveshjet e bashkëpunimit që Institucioni ka me partnerë të ndryshëm për mbarëvajtjen e programit të studimit. Dosjet fizike dhe elektronike të Personelit mbahen në Zyrën e Burimeve Njerëzore.</p> <p>Gjithashtu në faqen zyrtare ueb të Institucionit prezantohet i gjithë aktiviteti i kryer prej stafit akademik, ndihmës akademik, studentët sikurse edhe bashkëpunimet që institucioni ka me partner të ndryshëm</p> <p>https://umt.edu.al/</p> <p>Studentët që në momentin e regjistrimit në një program studimi, pajisen me adresë email-i personale me anë të të cilës komunikojnë në vazhdimësi për çdo gjë me stafin akademik të programit, stafin administrative etj. Gjithashtu stafi akademik i programit të studimit, komunikon me studentët nëpërmjet adresave të emailit të tyre dhe ndjek npm platformës edu4school ecurinë e tyre. Referuar takimit me studentët e Bsc. Informatikë Ekonomike - Anglisht, rezulton se studentët nëpërmjet kredencialeve të tyre personale, kanë akses në informacionin në lidhje me progresin dhe vlerësimet e tyre në lëndët respektive, nëpërmjet sistemit të informacionit të</p>

	<p>integruar. GVJ nga RVB si dhe nga vizita në institucion, konstaton se sistemi i informacionit përqëndrohet në dy platforma, “edu4school” dhe “Gotomeeting”.</p> <p><i>Aneks Nr.52-Manuale përdorimi të Sistemit informatik</i> <i>Aneks Nr.56-Manuale edu4school.</i> <i>Aneks Nr.69-Procesi mesimor ne kushte kovidi.</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Gjithë stafi dhe studentët e institucionit janë të pajisur me adresa email-i zyrtare duke u përdorur edhe kjo formë komunikimi nga pedagogët dhe studentët e programit të studimit përveç komunikimit të drejtpërdrejtë. GVJ vlerëson se sistemi i Manaxhimit të informacionit, “edu4schools” rezulton një platformë e cila ka të integruar 4 module, të cilat sigurojnë informacion dhe ju japin akses sekretarisë mësimore, studentëve, zyrës së menaxhimit financiar si dhe stafit akademik, duke ofruar shërbimin e informimit të tyre të ndërsjellë dhe të komunikimit të integruar. Nga takimet me studentët dhe stafin akademik, rezulton se përveç platformës “edu4schools”, në shërbim të tyre për zhvillimin e mësimit është edhe platforma “Gotomeeting”, që shërben për mësimdhënien online.</p> <p><i>Aneks Nr.52-Manuale përdorimi të Sistemit informatik</i> <i>Aneks Nr.56-Manuale edu4school.</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Sipas informacionit të siguruar gjatë takimeve me drejtues të njësisë kryesore dhe asaj bazë, rezulton se prej dy platformave gjenerohen raportime për drejtuesit, dhe mund të realizohen monitorime për procese të ndryshme, për zhvillimin e mësimit, për informimin e studentëve, duke i shërbyer vendimmarrësve për marrjen e vendimeve. Gjithashtu, përdoret edhe faqja zyrtare të institucionit, ku informacioni është i drejtpërdrejtë në kohë reale si për studentët që duan të informohen ashtu dhe për personelin akademik dhe administrativ që do të informojë.</p> <p>https://umt.edu.al/</p> <p><i>Aneks Nr.52-Manuale përdorimi të Sistemit informatik</i> <i>Aneks Nr.56-Manuale edu4school.</i></p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e</p>	<p>GVJ nga vizita e faqes zyrtare të institucionit, rezulton se aty publikohen informacione për stafin akademik, programet</p>

<p>studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>mësimore, kuotat, kriteret, aktivitetet, projektet etj në dy gjuhë, shqip dhe anglisht. Të gjitha informacionet e nevojshme që lidhen me programet e studimit, personelin akademik si dhe aktivitete të ndryshme merren nëpërmjet faqes elektronike të UMT, të cilat rezultojnë të përditësuara. Gjenden informacione të detajuara lidhur me planin mësimor të programit të studimit. Në faqen e UMT jepet informacion dhe për kushtet e pranimit në programin e studimit, objektivat dhe veprimtaritë formuese të programit, skemën e vlerësimit, mundësinë për studime të mëtejshme, mundësitë e punësimit dhe të kualifikimit profesional, etj. GVJ eksploroj mundësitë e ofruara për përfitim të informacionit dhe është i mendimit se informacioni i paraqitur është me interes si për studentët ashtu dhe për kandidatët për studentë.</p> <p>https://umt.edu.al/pranimet/</p> <p>https://umt.edu.al/en/research-and-projects;</p> <p>https://umt.edu.al/programet-master</p> <p>https://umt.edu.al/stafi-akademik/</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin mbahet nga Sekretaria Mësimore.</i></p> <p><i>Informacioni në lidhje me stafin akademik PAE, PAK dhe ndihmës akademik mbahet nga Zyra e burimeve njerëzore.</i></p> <p><i>Të gjitha informacionet e nevojshme që lidhen me programet e studimit, personelin akademik si dhe aktivitete të ndryshme merren nëpërmjet faqes elektronike të UMT, të cilat rezultojnë të përditësuara.</i></p> <p><i>Të dhënat për të gjithë studentët menaxhohen në platformën edu4school dhe gotomeeting..</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi IV.5</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>




<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>GVJ konstaton se në zbatim të legjisllacionit në fuqi, UMT harton një raport vjetor. Pjesë e këtij raporti rezulton të jetë edhe raportimi financiar i cili kalon nëpër të gjitha nivelet hierarkike, për njohje dhe sugjerime, për miratim final në bordin e Administrimit. Të ardhurat dhe shpenzimet, janë të detajuara sipas burimeve dhe sipas zërave të shpenzimeve.</p> <p>UMT raporton çdo vit akademik pranë MAS lidhur me veprimtarinë e tij duke përfshirë ndër të tjera dhe administrimin e të ardhura financiare/bursave/fondeve kërkimore. UMT është institucion i arsimit të lartë privat me vetëfinancim. Burimet financiare, përfshijnë tarifatat e shkollimit, projekte / grante ndërkombëtare të UMT, të ardhura nga shërbimet që ofron për të tretë, burime të tjera të ligjshme. Cdo vit institucioni finalizon pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve sipas zërave përkatës, sikurse edhe analizën kosto efektivitet.</p> <p>Referuar evidencës së konsultuar nga GVJ, rezulton se gjenden të detajuara të ardhurat nga tarifatat apo të ardhurat nga projektet, financimi nga administrator i UMT, si dhe shpenzimet sipas zërave të ndryshëm. Sipas RVB, institucioni deklaroi se në fazën e aplikimit të hapjes së programit Bsc Informatikë Ekonomike, është paraqitur një raport i detajuar, mbi financimin, kostot për student si dhe planifikimi për ecurinë e programit.</p> <p><i>Aneks Nr.59-Raport Auditues Pasqyrat Financiare.</i></p> <p><i>Aneks Nr.58-Buxheti i UMT-FE.</i></p> <p><i>Aneks Nr.57-Të ardhurat dhe financimet.</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet</p>	<p>Pavarësisht se GVJ nuk konstatoi plan financimi në nivel programor, referuar vizitës në UMT dhe nga RVB, konstaton se buxheti pavarësisht se paraqitet në nivel institucion në formën e tij finale, mënyra e hartimit të tij, përfshin disa nivele, nga poshtë -lart, duke nisur propozimet nga departamenti, të cilat paraqesin kërkesat buxhetore për financim, nisur nga kërkesat për të mbështetur cdo program studimi, për burime njerëzore, për shpenzime operative, për teknologjitë, shpenzimet për bibliotekën etj. Plani i financimit hartohet në nivel institucional, ku përfshihen të gjithë kostot dhe të ardhurat. Për shkak të përmasave të institucionit, por edhe faktit që infrastruktura por edhe stafi angazhohet në programe të ndryshme është praktikisht e pamundur të hartohen raporte në bazë të programeve të studimit. Në vijim buxheti planifikohet në nivel njësie kryesore, zyra e financës sintetizon buxhetin për të gjithë zërat në nivel institucioni dhe ia paraqet</p>

<p>financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Senatit, i cili bën miratimin paraprak, për të vijuar memiratimin nga Bordi i Administrimit të UMT. Nga analiza edhe e rregulloreve të brendshme, vihet re një procedurë e konsoliduar e hartimit të nevojave të brendshme të institucionit të cilat më pas reflektohen edhe në planifikimin e buxhetit të vitit pasardhës.</p> <p><i>Aneks Nr.59-Raport Auditues Pasqyrat Financiare.</i></p> <p><i>Aneks Nr.58-Buxheti i UMT-FE.</i></p> <p><i>Aneks Nr.57-Të ardhurat dhe financimet.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Nga RVB dhe takimi me GVB, rezulton se institucioni kryen auditime të përvitshme, të pavaruara nga kompani audit, por gjithashtu nga strukturat e UMT, ku zbatimi i buxhetit dhe pozicioni financiar i UMT është detyrë funksionale e zyrës së financës në UMT, në përputhje me rregulloren e institucionit. GVJ për këtë kriter i referohet RVB, si dhe të dhënavë për të ardhurat dhe shpenzimet që institucioni ka depozituar në dosjen e vlerësimit të brendshëm si dhe raportit të auditimit që gjenden në dosjen e vetëvlerësimit.</p> <p><i>Aneks Nr.59-Raport Auditues Pasqyrat Financiare.</i></p> <p><i>Aneks Nr.58-Buxheti i UMT-FE.</i></p> <p><i>Aneks Nr.57-Të ardhurat dhe financimet.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Bazuar në RVB, raportet hartohen në bazë institucioni dhe nuk janë të ndara sipas programeve specifike, për vetë natyrën e institucioneve jo publike të arsimit të lartë.</p> <p><i>Aneks Nr.59-Raport Auditues Pasqyrat Financiare.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare</p>	<p>Rezultojnë se UMT, ka një strukturë të posaçme për manaxhimin financiar sic dëshmohet nëpërmjet RVB. Këto struktura auditohen nga auditime të pavarura të certifikuara, të cilat dëshmojnë për qëndrueshmërinë financiare të institucionit, në mënyrë të përvitshme.</p> <p><i>Aneks Nr.59-Raport Auditues Pasqyrat Financiare.</i></p> <p><i>Aneks Nr.58-Buxheti i UMT-FE.</i></p> <p><i>Aneks Nr.57-Të ardhurat dhe financimet.</i></p>

institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.				
Konkluzione	<i>UMT dhe vetë programi i studimit paraqet qëndrueshmëri financiare. Dokumentacioni dhe takimet e kryera i mundësuan GVJ të konkludojë në ekzistencën e garancisë së stabilitetit financiar të këtij programi studimi, ndonëse në raportet financiare nuk jepet impakti financiar i ndarë sipas programeve të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ konstatoi se për programin e studimit Bachelor “Informatikë Ekonomike”, pranimi i studentëve, përparimi i tyre përgjatë kursit të studimit, vlerësimi i dijeve dhe diplomimi bazohet në aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Nga takimet në institucion, GVJ konstatoi se veprimtaria e njësisë bazë dhe kryesore, zhvillohet në përputhje me këto rregullore, të cilat janë hartuar në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe se u garantohet barazia dhe të drejta të njëjta të gjithë kandidatëve për studentë dhe studentëve që ndjekin studimet në këtë program studimi. GVJ referuar

	<p>dokumentacionit në dosjen e vetëvleresimit si dhe nga informacioni i siguruar në institucion, konstaton se UMT disponon politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen dhe transferimin e studentëve. GVJ është e mendimit se këto politika dhe procedura janë në përputhje me bazën ligjore rregullative.</p> <p><i>Aneksi Nr.02, Statuti i UMT</i> <i>Aneksi Nr.03, Rregullore e UMT.</i> <i>Aneks Nr.14 - Rregullore programi.</i> <i>Aneks Nr.67-Kriteret e pranimit nder vite.</i> <i>Aneks Nr.68- Procedurat e aplik, regj, transf, UMT.</i> <i>Aneks Nr.64-Proces-verbal pranimi.</i> https://umt.edu.al/pranimet/ https://umt.edu.al/transferimet-e-studimeve/</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se UMT ka një sërë rregulloresh dhe procedurash, duke filluar nga niveli institucional në tërësi e deri tek departamenti apo programi i studimit që mbulojnë një cikël të plotë nga hyrja deri në diplomim, të studentëve në programin e studimit Bachelor “Informatikë Ekonomike”. Orientimi dhe këshillimi i studentëve është i sanksionuar në dokumentat strategjik të institucionit. Ky informim nis nga momenti i informimit për programet akademike, para fillimit të cdo viti, nëpërmjet websatit të UMT ku gjenden të publikuara, programet, planet mësimore si dhe kuotat e kriteret.</p> <p>GVJ referuar evidencave si dhe informacionit gjatë takimit me studentët e programit të studimit Bachelor “Informatikë Ekonomike”, është e mendimit se aktet rregullatore ku sanksionohen politikat dhe procedurat që ndiqen nga hyrja në dalje e studentëve, ofrojnë trajtimin e drejtë dhe të barabartë të studentëve mbështetur mbi meritokracinë. Referuar këtu politikave të pranimit, atyre të frekuentimit, të ankimimit si dhe të vlerësimit të arritjeve akademike të studentëve, orientohen drejt garantimit të barazisë, paanshmërisë dhe transparencës dhe zbatimit të udhëzimeve dhe akteve nënligjore. Procedurat për hyrjen dhe ndjekjen e programit i referohen dhe respektojnë barazinë dhe të drejtat për cdo student. Të gjitha procedurat e shoqerojnë studentin përgjatë programit. Të gjitha këto procedura janë të pasqyruara edhe në rregulloren e institucionit si edhe në rregulloren e programit të studimit. Shpallja e fituesve për këtë program studim bazohet</p>

	<p>në udhëzimet e MASR si përsa i përket afateve ashtu edhe për dokumentacionin që nevojitet për regjistrim. Studentët fitues përzgjidhen duke u bazuar vetëm në kriteret e përcaktuara në vendimin e Senatit Akademik të UMT. Pranë UMT, kanë të drejtë të aplikojnë dhe regjistrohen të gjithë kandidatët të cilët kanë një notë mesatare nga matura shtetërore sipas legjislacionit në fuqi në vend. Nga takimi që GVJ pati me Sekretarinë Mësimore, evidentoi se numri i studentëve të regjistruar për herë të parë, në programin e studimit për vitet akademike përkatëse është :</p> <p>2021-2022 - 4 studentë;</p> <p>2022-2023 - 9 studentë dhe 9 të transferuar;</p> <p>2023-2024 - 22 studentë;</p> <p><i>Aneksi Nr.02, Statuti i UMT</i></p> <p><i>Aneksi Nr.03, Rregullore e UMT</i></p> <p><i>Aneks Nr.14 - Rregullore programi.</i></p> <p><i>Aneks Nr.67-Kriteret e pranimi nder vite.</i></p> <p><i>Aneks Nr.68- Procedurat e aplik, regj, transf, UMT.</i></p> <p><i>Aneks Nr.64-Proces-verbal pranimi.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Çdo fillim viti akademik, njësia bazë, përgjegjëse për programin e studimit, propozon kriteret për përzgjedhjen e studentëve. Kriteret e pranimi miratohen me vendim të Senatit Akademik të UMT.</p> <p>Nga takimi i GVJ me stafin e angazhuar në programin e studimit "Informatikë Ekonomike", pedagogët u shprehën se kandidatët e interesuar mund të gjejnë informacion në lidhje me to në faqen e ueb të institucionit, duke kontaktuar me Zyrën e këshillimit të karrierës apo edhe në ditët e hapura të informimit që organizohen nga institucionet e arsimit universitar. Edhe nga studentët të cilët ishin në takim na u konfirmua se burimi i informacionit për institucionin dhe programin e studimit ka qënë faqja zyrtare web i institucionit. Në dosjen e programit të studimit në fjalë paraqiten në mënyrë të detajuar, studentët potencialë, objektivat e formimit si edhe punësimi i mundshëm i tyre. Duke qënë se gjuha e programit të studimit është anglishtja, krijon mundësi për regjistrim edhe të studentëve të huaj.</p> <p><i>Aneksi Nr.03, Rregullore e UMT</i></p>

	<p><i>Aneks Nr.66-Propozim kuotat e pranimit FE.</i></p> <p><i>Aneks Nr.14 - Regullore programi.</i></p> <p><i>Aneks Nr.63- Raport i MASR mbi certif. kuatave.</i></p> <p><i>Vizita në institucion- takim me stafin akademik dhe studentët</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e regjistrimit bazohen në legjislacionin në fuqi dhe shpallen pas miratimit të tyre në Senatin Akademik</p> <p>Kriteret e pranimit bëhen publike në faqen e internetit të UMT. Elementët më të detajuar lidhur me pranimin e studentëve jepen në Rregulloren e programit të studimit. Gjithashtu Institucioni ka përcaktuar rregullat dhe procedurat për transferime.</p> <p><i>Aneks Nr.66-Propozim kuotat e pranimit FE</i></p> <p><i>Aneks Nr.14 - Regullore programi.</i></p> <p><i>Aneks Nr.68- Procedurat e aplik, regj, transf, UMT.</i></p> <p>https://umt.edu.al/pranimet/</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në RVB si edhe gjatë takimit që GVJ pati me studentët e këtij programi studimi, evidentohet se institucioni nëpërmjet faqes zyrtare web, mediave sociale si edhe TV kombëtare, informon publikun si edhe grupet e interesit në lidhje me programet e studimit që ofrohen nga UMT si dhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për tu rregjistruar në programet e studimit.</p> <p><i>Ev. RVB Bachelor ne Informatike Ekonomike-Anglisht.</i></p> <p><i>Ev. Vizita në institucion- takim me studentët</i></p> <p>https://umt.edu.al</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>UMT ndjek politika të mbështetjes së kategorive sociale të veçanta. Kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve nga këto kategori bëhen publike para fillimit të vitit akademik në faqen web të institucionit (https://umt.edu.al/) Pranimi i studentëve bazohet në aktet e brendshme rregullatore, duke përcaktuar kriteret e veçanta për pranimin në varësi të programit specifik të studimit.</p> <p><i>Aneks Nr.2 - Statuti.</i></p> <p><i>Aneks Nr.14 - Regullore programi.</i></p> <p><i>Aneks Nr.68- Procedurat e aplik, regj, transf, UMT.</i></p> <p><i>Aneks Nr.70-Vendim rektori per pranimet.</i></p>

	<i>Aneks Nr.71-Mbi komisionin e pranimit te stud.</i>		
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Gjuha e mësimdhënies në këtë program studimi është anglishtja. Gjatë takimit që GVJ pati me Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë si edhe me drejtuesin e Departamentit së Informatikës Ekonomike, u evidentua se nuk ka studentë të huaj, që nga hapja e programit deri në këtë vit akademik. <i>Aneks Nr.14 - Rregullore programi.</i>		
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtesa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	UMT ofron bursa në varësi të mesatares së notave në maturën shtetërore dhe/ose në vitet e studimit në UMT. Gjithashtu institucioni ndan informacione të ndryshme në lidhje me mundësitë për bursa apo financime për studentët. https://umt.edu.al/bursa-dhe-tarifa-studimi/		
Konkluzione	<i>Nga shqyrtimi i DVV dhe vizita në institucion, GVJ konstatoi se për programin e studimit Bachelor "Informatikë Ekonomike, pranimi i studentëve, përparimi i tyre përgjatë kursit të studimit, vlerësimi i dijeve dhe diplomimi bazohet në aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Në mënyrë të veçantë realizimi i këtyre elementëve mbështetet në Statutin e UMT, Rregulloren e UMT dhe Rregulloren e programit të studimit.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të	Programi i studimit "Informatikë Ekonomike" realizohet me 180 kredite (ECTS) dhe kohëzgjatja akademike është 3 vjet. Sasia e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student është 57 kredite për vitin e parë, 60 kredite për vitin e dytë dhe 63 kredite për vitin e tretë. Studimet e këtij programi përmbillen me projektin përfundimtar pra me punimin e diplomës. Studentët e programit të studimit njihen me




<p>studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit nëpërmjet informacioneve në faqen e internetit të UMT por edhe në ditët informuese lidhur me programet e studimit. Elementë më të detajuar lidhur me planin mësimor, kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin gjenden në rregulloret përkatëse.</p> <p><i>Aneks Nr.25-Plani mesimor.</i> <i>Aneks Nr.12-Programet ne FE.</i> <i>Aneks Nr.3 -Rregullore UMT.</i> <i>Aneks Nr.11 - Rregullore FE.</i> <i>Aneks Nr.14 - Rregullore programi.</i> <i>Aneks Nr.91-Java e orientimit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Neni 21 në Rregulloren e programit të studimit, jep elementët që lidhen me transferimet dhe kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. Studentët apo kandidatët për studentë në këtë program studimi mund të njihen me këta elementë duke aksesuar edhe nëpërmjet linkut: https://umt.edu.al/transferimet-e-studimeve/ Gjithashtu GVJ, e konfirmoi këtë procedurë edhe gjatë vizitës në Sekretarinë Mësimore.</p> <p><i>Aneks Nr.14 - Rregullore programi.</i> <i>Aneks Nr.68- Procedurat e aplik, regj, transf, UMT.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Informacioni në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit përftohet nëpërmjet rregullores së programit të studimit si edhe syllabuseve të lëndëve. GVJ u informua se elementët më të detajuar për lëndët që bëjnë pjesë në programin e studimit, jepen nga pedagogët në seancën e parë, duke u bërë të njohur dhe vënë në dispozicion të studentëve të syllabusit të lëndës dhe duke detajuar objektivat e lëndës, temat përkatëse, elementët formues të programit (leksione, ushtrime, detyra kursi, laboratorë et.), mënyrën e shlyerjes si dhe literaturën përkatëse. Nga takimi me studentët e programit, stafin akademik si dhe përfaqësues së zyrës së këshillimit të studentëve, rezulton se studentët informohen cdo fillim semestri prej pedagogëve të lëndëve, për procedurat e vlerësimit të dijeve. Këtij qëllimi i shërbejnë edhe javët orientuese që institucioni mban, për të orientuar studentët që</p>

	<p>synojnë të regjistrohen në këto programe, apo që tashmë janë regjistruar.</p> <p><i>Aneks Nr.14 - Rregullore programi.</i> <i>Aneks Nr.61-Guida e studentit.</i> <i>Aneks Nr.91-Java e orientimit.</i> <i>Aneks Nr.27.1 SilabusetV1.</i> <i>Aneks Nr.27.2 SilabusetV2.</i> <i>Aneks Nr.27.3 SilabusetV3.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Në rregulloren e institucionit dhe bazën ligjore të institucionit janë parashikuar kriteret dhe procedurat e diplomimit. Mbrojtja e diplomës është detyrimi përfundimtar për diplomimin e studentit. Mbrojtja bëhet përmes paraqitjes së një punimi diplome. Në kuadër të informimit të plotë të studentëve dhe orientimit të tyre, rezulton se njësisia bazë informon studentët për kriteret dhe metodologjinë e përgatitjes së punimit të mikrotezës. Studentëve iu vihet në dispozicion udhëzuesi i diplomës, ndjekjen e zbatimit të së cilit e realizojnë udhëheqsit e diplomës. Për programin e studimit “Informatikë Ekonomike, shlyerja e detyrimit përfundimtar, bëhet nëpërmjet projekt diplomës i cili ka 6 (gjashtë) kredite. Për këtë program studimi, të diplomuarit e parë do të jenë në këtë vit akademik (2023-2024).</p> <p><i>Aneks Nr.3 -Rregullore UMT.</i> <i>Aneks Nr.11 - Rregullore FE.</i> <i>Aneks Nr.41-Modeli i diplomes.</i> <i>Aneks Nr.49-Procedurat e pergatitjes se diplomes.</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Referuar RVB dhe takimeve në institucion, GVJ u informua se institucioni, në fillim të çdo viti akademik, periodikisht përpara se studentët të përzgjedhin programet e tyre të studimit organizon takime të hapura informimi me ta, nëpërmjet zyrës së shërbimit ndaj studentëve e cila bashkëpunon me njësitë bazë përgjegjëse për secilin nga programet e studimit. Gjithashtu faqja e internetit e UMT (https://umt.edu.al/) ofron një gamë të gjerë informacionesh në lidhje me kushtet e pranimit në programin e studimit, objektivat dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit, skemën e vlerësimit, mundësinë për studime të mëtejshme, mundësitë e punësimit dhe të kualifikimit profesional dhe planin mësimor të programit të studimit. Nga takimi me përfaqësues të zyrës e</p>

	<p>karrierës, UMT orienton studentët potencial, nëpërmjet komunikimit të drejtëpërdrejtë me ta si dhe organizimit të javës orientuese. Gjithashtu një instrument tjetër informimi orientimi në kohë reale, institucioni përdor edhe rrjetet sociale si dhe websaitin e institucionit.</p> <p><i>Aneks Nr.91-Java e orientimit.</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Studentët e programit të studimit njihen me strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit nëpërmjet informacioneve në faqen së internetit të UMT. Elementë më të detajuar lidhur me planin mësimor, kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin gjenden në rregulloret përkatëse.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se studentët janë të informuar në lidhje me strukturën e programit të studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e tij. Studentët informohen në mënyrë të detajuar nga ana e pedagogëve përkatës në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor për lëndët përkatëse, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Ky informacion u transmetohet që në javën e parë të fillimit të procesit mësimor gjatë prezantimit të syllabuseve të lëndëve, detyrimeve përkatëse, mënyrës së shlyerjes së tyre dhe infrastrukturës laboratorike e kompjuterike në dispozicion të tyre Sekretaria mësimore gjithashtu ofron informacion të përgjithshëm mbi programet e studimit/lëndët përkatëse. Gjithashtu, GVJ, nga vizita në institucion si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstaton se UMT nëpërmjet organizimit të javëve orientuese, takimeve të drejtuesve më studentët, i orienton ata për kohëzgjatjen e studimeve, për strukturën e programit, për organizimin dhe zhvillimin e tij, etj</p>

	<p><i>Aneks Nr.27.1 SilabusetV1.</i> <i>Aneks Nr.27.2 SilabusetV2.</i> <i>Aneks Nr.27.3 SilabusetV3.</i> <i>Aneks Nr.15 -Dosja e Programit.</i> <i>Aneks Nr.91-Java e orientimit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, konsultimi i faqes së internetit, takimet në institucion, GVJ u informua se UMT shpërndan informacion nëpërmjet faqes së internetit (https://umt.edu.al/) ku pasqyrohen një numër elementësh të tjerë duke informuar studentët në lidhje me programet e studimit dhe detyrat dhe përgjegjësitë që ata kanë. Një rol të rëndësishëm gjithashtu në informimin e studentëve luan edhe Zyra e Çështjeve të Studentëve. Syllabuset që çdo pedagog prezanton në fillim të lëndës japin informacion të qartë për përmbajtjen dhe kërkesat që studenti duhet të plotësojë. Takimet me studentët dëshmuar se ata janë të informuar rreth lëndëve, moduleve, formave të vlerësimit, detyrimeve lëndore. Këto informacione jepen kryesisht nga pedagogët në seancën e parë të zhvillimit të semestrit. Studentët nëpërmjet sistemit “edu4schools”, marrin informacion në kohë reale për modulet, lëndët dhe cdo informacion rreth dosjes së programit Bachelor “Informatikë Ekonomike”.</p> <p><i>Aneks Nr.27.1 SilabusetV1.</i> <i>Aneks Nr.27.2 SilabusetV2.</i> <i>Aneks Nr.27.3 SilabusetV3.</i> <i>Aneks Nr.15 -Dosja e Programit.</i> <i>Aneks Nr.91-Java e orientimit.</i> <i>Aneks Nr.61-Guida e studentit.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Në organigramën e UMT është dhe Zyra e Karrierës. Ndër aktivitetet më të rëndësishme të Zyrës së Karrierës është dhe panairi i punës si një aktivitet i përvitshëm dhe që jep mundësinë e zhvillimit të formës më bashkëkohore të rekrutimit të studentëve. Ai shërben si një urë e drejtpërdrejte komunikimi mes tregut të punës dhe punëkërkuarëve të ardhshëm (studentëve) nga çdo fushë studimi e UMT. Në faqen e internetit të UMT, në rrjetet sociale apo në ambientet e brendshme të institucionit, në mënyrë të vazhdueshme publikohen njoftime për mundësi internship-i apo punësimi për studentët. GVJ, nga takimi i zhvilluar me zyrën e karrierës së</p>

	<p>UMT si dhe nga shqyrtimi i informacionit të DVV dhe faqes së internetit, është i mendimit se lidhja me biznesin është në nivele të kënaqshme dhe se mbështetet fuqimisht orientimi i studentëve drejt dhe në tregun e punës.</p> <p><i>Aneks Nr.76-Rregullore e zyres se karrieres.</i> <i>Aneks Nr.10 - Organigrama FE.</i> <i>Aneks Nr.90-Lista e stud. Alumni.</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Javët e informimit, rezultojnë se janë orientuese për t'i njohur dhe familjarizuar studentët me mjedisin e UMT. Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim luan dhe Sekretaria Mësimore. Nëpërmjet sekretarisë, departamentit, si dhe nëpërmjet ëeb sitit e guidës së studentit, studentët informohen për organizimin e procesit mësimor, orarit, sallave/laboratorëve etj. Studentët informohen në mënyrë të detajuar nga ana e pedagogëve përkatës në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Elementë të tjerë si orari i mësimave, struktura e vitit akademik, datat e provimeve apo datat e shlyerjeve të detyrimeve, aksesohen gjithashtu edhe nëpërmjet faqes së internetit të institucionit. Po ashtu, nëpërmjet faqes së internetit mund të përftohesh edhe njoftime për tarifat e studimit, bursat etj.</p> <p>Gjithashtu në javën e parë të fillimit të cdo viti akademik, institucioni organizon ditët e hapura, gjatë së cilës studentët orientohen dhe informohen për gjithcka që lidhet me programin e studimit, procesin mësimor, infrastrukturën etj. GVJ e gjen një praktikë të tillë në përputhje me standardin.</p> <p><i>Aneks Nr.91-Java e orientimit.</i> <i>Aneks Nr.61-Guida e studentit.</i></p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Përveç aktiviteve informuese sic janë javët orientuese si dhe informacionit verbal, studentët rezultojnë se përdorin aktivisht platformën edu4school, për të marrë informacion rreth syllabuseve, leksioneve, detyrimeve lëndore, rezultatet e provimeve etj. Studentët që regjistrohen për herë të parë pranë UMT, pajisen me adresë emaili dhe gjithashtu kanë mundësi të aksesojnë në platformën edu4school.</p> <p><i>Aneks Nr.52-Manuale përdorimi të Sistemit informatik.</i></p>




Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se studentët janë të informuar në lidhje me strukturën e programit të studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e tij. Studentët informohen në mënyrë të detajuar nga ana e pedagogëve përkatës në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, praktikën profesionale, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Ky program studimi do të ketë të diplomuarit e parë në përfundim të këtij viti akademik pra 2023-2034. GVJ gjatë vizitës në UMT si dhe takimeve me përfaqësues të sekretarisë mësimore, konstaton se UMT, disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në të gjitha programet e studimit. Sipas informacionit të siguruar përveç regjistrave të institucionit, që GVJ konsultoi, këto informacione ruhen edhe në mënyrë elektronike në platformën “edu4schols”.
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	GVJ konsultoi regjistrat themeltar për Bachelor Informatikë Ekonomike, të cilët kanë të regjistruarit e cdo viti, studentët e larguar apo të tërhequr si dhe të diplomuarit e cdo viti. Numri i studentëve të regjistruar për herë të parë, për vitin akademik: <ul style="list-style-type: none"> - 2021-2022 4 studentë; - 2022-2023 18 studentë; - 2023-2024 22 studentë;




<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>GVJ konsultoi proceverbale të lëndëve, vlerësimet e studentëve për lëndë të ndryshme, si dhe regjistrat e notave dhe konstatoi përputhshmëri mes formave të vlerësimit në syllabus si dhe regjistrave të notave. Nga takimi me studentët rezultoi se studentët për vlerësimet e tyre informohen nëpërmjet sistemit informatik, “edu4schols”, në të cilin pedagogët hedhin vlerësimet e lëndës, ku cdo përdorues aksesohet nëpërmjet kredencialeve individuale.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njëjësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritet mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion, konsultoi regjistrat themeltar ku çdo student, është regjistruar dhe ishte pajisur me numër matrikullimi. Gjithashtu GVJ konsultoi dosje të studentëve të regjistruar, të cilat përmbanin dokumentacionin e duhur dhe të noterizuar, si diploma e bachelorit, listë notash, fotokopje e kartës së identitetit, dëshmi e gjuhës së huaj etj.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>UMT disponon të dhëna për ecurinë e studentëve, gjatë zhvillimit të programit të studimit, Bachelor Informatikë Ekonomike, që nga pranimi (mesataren në hyrje) dhe rezulton se i analizon ato në analizat vjetore, për identifikuar ndryshimet në cilësinë e aplikimeve dhe pranimeve.</p> <p>Rezultoni se mesatarja në hyrje është:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2021-2022 8.63 - 2022-2023 8.82 - 2023-2024 8.92 <p>Mesatarja në dalje rezultoni:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2021-2022 7.75 - 2022-2023 7.94 - 2023-2024 në proces




	<p><i>Aneks Nr.40-Rregullore e sekretarise.</i></p> <p><i>Aneks Nr.77-Dosje studenti.</i></p> <p><i>Aneks Nr.43-Rregullore e Arkives.</i></p> <p><i>Aneks Nr.11 - Rregullore FE.</i></p> <p><i>Aneks Nr.60-Raport vjetor i aktiviteti mësimor.</i></p> <p><i>Aneks Nr.65-Cilësia në hyrje & dalje e stud.</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Statistikat vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mos përfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve mbahen nga Sekretaria Mësimore.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi V.5	
<p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Referuar vizitës në institucion si dhe takimeve me drejtues të njësisë kryesore, asaj bazë si dhe me studentë të programit Bachelor Informatikë Ekonomike, UMT në aktet e brendshme rregullatore, Statut, Rregullore dhe Rregullore e Senatit Studentor, parashikon përfshirjen e studentëve në organe vendimmarrëse, si senat, NJSBC, komisione ad-hoc etj.</p> <p><i>Aneks Nr.2 - Statuti.</i></p> <p><i>Aneks Nr.3 -Rregullore UMT.</i></p> <p><i>Aneks Nr.9-Vendim mbi ngritjen GVB.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të</p>	<p>Nga informacioni i vënë në dispozicion dhe nga takimet me drejtues, staf dhe studentët e programit Bachelor Informatikë Ekonomike, GVJ është e mendimit se UMT, nxit dhe garanton përfshirjen e studentëve, në organe vendimmarrëse si senati akademik, përfshirje në NJSBC dhe në komisione ad-hoc. Gjithashtu nëpërmjet pyetësorëve, studentët përcjellin në</p>

<p>jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>organet vendimmarrëse perceptimin e tyre, rreth proceseve mësimore dhe atyre vlerësuese.</p> <p><i>Aneks Nr.2 - Statuti.</i></p> <p><i>Aneks Nr.3 -Rregullore UMT</i></p> <p><i>Aneksi Nr.79, Përbërja e NJSBC</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Sic rezultoi nga takimi që GVJ pati me përfaqësues të studentëve dhe të NJSBC, institucioni organizon dy herë në vit, pyetësorë për studentët për të siguruar informacion dhe sugjerime prej tyre rreth, ecurisë së programit të studimit.</p> <p><i>Aneks Nr.80-Model i pyetësorit per studentet.</i></p> <p><i>Aneks Nr.88-Raportet e NJSBC per proc. mësimor.</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>GVJ konstaton se studentët kanë të sanksionuar në rregullore, të drejtën e ankimimit si dhe të drejtën e rishikimit të rezultateve të vlerësimit të tyre. Referuar takimeve me stafin akademik dhe me studentët e programit Bachelor Informatikë Ekonomike, rezulton se ata kanë të drejtën e ankimimit të rezultatit dhe konsultimit me tezën e provimit për tu qartësuar për vlerësimin e tyre.</p> <p>Gjithashtu nëpërmjet anketimeve semestrale, studentët kanë të drejtë të shprehin perceptimet e tyre, mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve.</p> <p><i>Aneks Nr.37-Rregullore e Provimeve.</i></p> <p><i>Aneks Nr.80-Model i pyetësorit per studentet.</i></p> <p><i>Aneks Nr.88-Raportet e NJSBC per proc. mësimor.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UMT garanton përfshirjen e studentëve në menaxhim dhe në vendimmarrje duke mundësuar përfaqësimin e tyre në Senat, NJSBC, dhe në të gjitha komisionet e organizuara në UMT si dhe në grupin e vlerësimit të brendshëm dhe përgatitjen e RVB.</i></p>




Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
<p>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>GVJ konstatoi se institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit dhe shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të UMT. Në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zyra e Karrierës dhe Alumni; - Sekretaria mësimore - Zyra e shërbimit ndaj studentëve <p>UMT organizon çdo vit, për studentët e rinj, Ditët e hapura të Studentëve.</p> <p><i>Aneks Nr.91-Java e orientimit.</i> <i>Aneks Nr.3 -Rregullore UMT.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Për të mundur informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, përveç Sekretarisë Mësimore e cila disponon dhe vë në dispozicion të studentëve gjithë informacionin në lidhje me regjistrimin dhe avancimin akademik të tyre, një rol të veçantë luan edhe Zyra e shërbimit ndaj studentëve. GVJ konstatoi se një mjet i fuqishëm për informimin e studentëve është dhe faqja e internetit e UMT, (https://umt.edu.al/) si edhe mediat sociale e cila përditësohet rregullisht dhe që nga studentët informohen për një seri elementësh si njoftime për mobilitete, aplikime për bursa, trajnime, internship-e, ëëbinare, trajnime, leksione të hapur etj.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës</p>	<p>GVJ u informua për funksionimin në UMT të Zyra e Karrierës dhe Alumni. Nga takimi me përfaqësues të sekretarisë dhe Zyrës së Karrierës dhe Alumni, rezulton se kjo zyrë, asiston studentët dhe këshillon ata për ecurinë e karrierës së tyre, duke i orientuar drejt mundësive të punësimit, apo për oportunitetet</p>

<p>mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>e zgjedhjes dhe zhvillimit të praktikës profesionale, pranë kompanive, më të cilat UMT ka marrëveshje dhe që konsiderohen aktive, si dhe për trajnimet e ndryshme për studentët</p> <p><i>Aneks Nr.76-Rregullore e zyrës se karrieres.</i> <i>Aneks Nr.90-Lista e stud. Alumni.</i></p>
---	--

<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Institucioni, si dhe takimeve përfaqësues të zyrës, institucioni nëpërmjet zyrës së këshillimit të karrierës, kryesisht, ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit, nëpërmjet pyetësorit të Alumnit, duke azhurnuar të dhënat me të diplomuarit si dhe më punësimin e tyre. Në vijim institucioni, përgatit statistika për punësimin e studentëve për organet drejtuese për vendimmarrje të ndryshme të tyre.</p> <p><i>Aneks Nr.76-Rregullore e zyrës se karrieres.</i> <i>Aneks Nr.90-Lista e stud. Alumni.</i></p>
---	--

<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstatoi se UMT ka procedura dhe njësi të posaçme të cilat sigurojnë orientimin, mbështetjen dhe këshillimin e studentëve në mënyrë të përhershme. Zyra e Karrierës dhe Alumni, Sekretaria Mësimore dhe Zyra e Shërbimit ndaj Studentëve ofrojnë një gamë të gjerë të shërbimeve për studentët. Përdorimi i burimeve të internetit dhe medias sociale përmirëson aksesin e studentëve në informacione dhe ndihmon në komunikimin e tyre me institucionin.</i></p>
---------------------------	--

<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>




VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Bazuar edhe në Strategjinë e mesimdhënies, mësimnxënies dhe metodave të vlerësimit, ndër të tjera janë hartuar edhe planveprimet për përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies. UMT, ka përdorur gjatë periudhës së pandemisë përdor sistemin e-learning duke zhvilluar gjithashtu edhe zhvillimet online. Gjithashtu, aktive në UMT, duke patur abonim të përvitshëm, studentët dhe stafi akademik kanë akses për përdorimin e bibliotekës online.</p> <p><i>Aneks Nr.52-Manuale përdorimi të Sistemit informatik.</i> <i>Aneks Nr.5-Draft Strategjia 22-27.</i> <i>Aneks Nr.56-Manuale edu4school.</i> <i>Aneks Nr.35-Permiresimi i kurrikules.</i> <i>Aneks Nr.69-Procesi mesimor ne kushte kovidi.</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Zhvillimi i vazhdueshëm i leksioneve të hapura pranë UMT, i vjen në ndihmë stafit të ri akademik për marrjen e eksperiencës dhe përvojës. Gjithashtu stafi akademik, vlerësohet cdo vit nëpërmjet një formulari të hartuar dhe miratuar në UMT në lidhje me disa elementë të tilla si: komunikimi, aftësia për të punuar në grup, cilësia e mësimdhënies, risitë dhe inovacioni në mësimdhënie, kërkimi shkencor etj. Vlerësimi i stafit akademik bëhet gjithashtu nga studentët në përfundim të cdo semestri.</p> <p><i>Aneks Nr.88-Raportet e NJSBC per proc. mesimor.</i> <i>Aneks Nr.44-Formular Vleresim performance.</i> <i>Aneks Nr.80-Model i pyetësorit per studentet.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të</p>	<p>UMT, organizon në përfundim të cdo semestri anketimin e studentëve, të cilët shprehin lirshëm mendimin dhe opinionin e tyre në lidhje me pedagogët e lëndëve që ata kanë zhvilluar në semestrin përkatës. Të dhënat e mbledhura, përpunohen në nivel departamenti të cilët së bashku më përgjegjësit e grupeve</p>

<p>mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>mësimore diskutojnë në lidhje me problematikat e evidentuara duke ndërmarrë gjithashtu edhe masa për përmirësim dhe zgjidhje të problemeve në rast evidentimi të tyre. Sikurse theksohen në Rregulloren e UMT si edhe në rregulloren e programit të studimit, studenti ka të drejtën e ankimimit të vlerësimit të bërë nga pedagogu i lëndës.</p> <p><i>Aneks Nr.3 -Rregullore UMT.</i> <i>Aneks Nr.14 - Regullore programi</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Sikurse edhe në kriteret më sipër, rezultatet e anketimit të studentëve u dërgohen me email cdo pedagogu, ku secili prej tyre vihet në dijeni vetëm për vlerësimin e tyre të bërë nga studentët. Më pas rezultatet diskutohen në departament. Pasi diskutohen në nivel departamenti, hartohet edhe raporti që pasi miratohet në njësinë bazë, përcillet në njësinë kryesore. Gjithashtu vlerësimi i stafit akademik bëhet edhe nga njësia bazë nëpërmjet formularit për vlerësimin e performancës. Raporti gjithashtu shqyrton edhe analizën mësimore kërkimore në nivel departamenti sikurse edhe në nivel fakulteti.</p> <p><i>Aneks Nr.88-Raportet e NJSBC per proc. mësimor.</i> <i>Aneks Nr.44-Formular Vleresim performance.</i> <i>Aneks Nr.80-Model i pyetësorit per studentet.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Pjesë e Planit Stategjik të UMT, ndër të tjera është zhvillimi, trajnimi dhe kualifikimi i vazhdueshëm i stafit, si në aspektin e mësimdhënies ashtu edhe në aspektin e kërkimit shkencor. UMT ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë jashtë vendit dhe në kuadër të projekteve Erasmus, organizon mobilitete të stafit akademik për mësimdhënie ashtu sikurse edhe për trajnime. Gjithashtu pasi bëhet analiza e vlerësimit të performancës të stafit akademik, bëhet e mundur edhe promovimi i stafit.</p> <p><i>Aneks Nr.88-Raportet e NJSBC per proc. mësimor.</i> <i>Aneks Nr.44-Formular Vleresim performance.</i> <i>Aneks Nr.80-Model i pyetësorit per studentet.</i> <i>Aneks Nr.19-Lista e shkëmbimeve ndërkomb.</i> <i>Aneks Nr.20-Lista e marrevshjeve.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UMT, organizon në përfundim të cdo semestri anketimin e studentëve, të cilët shprehin lirshëm mendimin dhe opinionin e</i></p>




	<p>tyre në lidhje me pedagogët e lëndëve që ata kanë zhvilluar në semestrin përkatës. Të dhënat e mbledhura, përpunohen në nivel departamenti të cilët së bashku më përgjegjësit e grupeve mësimore diskutojnë në lidhje me problematikat e evidentuara duke ndërmarrë gjithashtu edhe masta për përmirësim dhe zgjidhje të problemeve në rast evidentimi të tyre.</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Referuar Statutit, në UMT është ngritur edhe Njësia e Sigurimit të Cilësisë, e cila bashkëpunon dhe bashkërendon punën me njësitë e sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel njësie kryesore. Nga dokumentacioni në dosjen e vetëvlerësimit, rezulton se NJSBC në nivel institucioni është krijuar në 2019, ka në përbërje të saj 6 anëtare, mes të cilëve një student, një ekspert të jashtëm për çështjet e cilësisë, përfaqësues nga cdo fakultet si dhe nga administrata. NJSBC në nivel institucioni, funksionon mbi rregulloren e miratuar.</p> <p><i>Aneks Nr.2 - Statuti.</i> <i>Aneksi Nr.82, Rregullorja e NJSBC.</i> <i>Aneksi Nr.79, Përbërja e NJSBC</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Institucioni ka ngritur një sërë mekanizmesh në funksion të sigurimit të cilësisë së brendshme të tilla si: rishikimi i kurrikulave, rishikimi i syllabuseve në mënyrë periodike, disa mekanizma të vlerësimit të stafit akademik ku një rol të rëndësishëm luan vlerësimi nga studentët.</p> <p>Funksionimi i sistemit të sigurimit të cilësisë përshkruhet në rregulloren përkatëse. Institucioni e monitoron cilësinë nëpërmjet Njësies së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë pranë secilit Fakultet si edhe Komisionin e Perhershem te Sigurimit dhe Standardeve te Cilesise. Kjo njësi është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. NJSBC monitoron cilësinë e</p>

	<p>mësimdhënies, vlerësimin periodik, ndjekjen dhe zhvillimin e pyetsorit të stafit dhe studentëve për cilësinë e ofrimit të programeve të studimit, etj.</p> <p><i>Aneks Nr.2 - Statuti.</i> <i>Aneksi Nr.82, Rregullorja e NJSBC.</i> <i>Aneksi Nr.79, Përbërja e NJSBC</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>UMT i nënshtrohet akreditimit të jashtëm periodik. UMT i është akorduar akreditimi institucional me Vendim BA Nr. 05, datë 27.01.2023 (<i>RVB Bachelor ne Informatike Ekonomike-English</i>).</p> <p>Programi i studimit të Bachelor në “Informatikë Ekonomike” është liçensuar përmes vendimit të Urdhërit të MASR nr. 492 datë 27.07.2018 dhe vlerësimi i jashtëm i këtij programi studimi me qëllim akreditimin e programit, po realizohet për herë të parë nga ASCAL. UMT bën përpjekje të vazhdueshme në kuadër të NJSBC-së, për përmirësimin e cilësisë.</p> <p>NJSBC ka hartuar paketën e instrumentave të cilësisë dhe GVJ nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe nga takimi me NJSBC evidentoi zhvillimin e anketimeve me studentët në trajtën e pyetësorëve dhe transmetimin e informacionit te drejtuesi i Departamentit. GVJ konstatoi se ka patur hartim raportesh të vlerësimit për programin e studimit shoqëruar me analizë, ku integrohen rezultatet e pyetësorëve për vlerësimin e stafit akademik në nivel departamenti si dhe është operuar me nxjerrjen e konkluzioneve të pasqyruar në raporte si dhe me plan aksioni për të adresuar problematikën e konstatuar.</p> <p><i>Aneks Nr.7-Licensimi programit.</i> <i>Aneks Nr.6-Akred. Institucional.</i> <i>Aneks Nr.8-Aplikim per akredim programi.</i> <i>Aneks Nr.88-Raportet e NJSBC per proc. mësimor.</i> <i>Aneks Nr.44-Formular Vleresim performance.</i> <i>Aneks Nr.80-Model i pyetësorit per studentet.</i> <i>Aneks Nr.35-Permiresimi i kurrikules.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes,</p>	<p>Referuar RVB, takimeve me NJSBC, stafin dhe studentët rezulton se UMT përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programit. Rezulton se nga NJSBC, zhvillohen pyetësorë para përfundimit të cdo semestri. Synimi i këtyre analizave nuk është vetëm të evidentohen pikat</p>

<p>arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira ne programin e studimit.</p>	<p>e forta apo edhe mangësitë por qëllimi kryesor është të hartohen e ndërmeren plane veprimi për përmirësim. Njësia kryesore dhe ajo bazë rezultojnë të zhvillojnë procese monitorimi, sipas një plani monitorimi. Planet mësimore dhe syllabuset, ndryshohen për të siguruar përputhshmërinë me bazën ligjore por edhe për tu përmirësuar.</p> <p><i>Aneks Nr.88-Raportet e NJSBC per proc. mësimor.</i></p> <p><i>Aneks Nr.44-Formular Vleresim performance.</i></p> <p><i>Aneks Nr.80-Model i pyetësorit per studentet.</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni ka ngritur një sërë mekanizmesh në funksion të sigurimit të cilësisë së brendshme të tilla si: rishikimi i kurrikulave, rishikimi i syllabuseve në mënyrë periodike, disa mekanizma të vlerësimit të stafit akademik ku një rol të rëndësishëm luan vlerësimi nga studentët.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi VI.3</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p>	<p>Referuar RVB, takimeve me NJSBC, stafin dhe studentët rezulton se UMT përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programit. Rezultoni se nga NJSBC, zhvillohen pyetësorë para përfundimit të cdo semestri. Njësia kryesore dhe ajo bazë rezultojnë të zhvillojnë procese monitorimi, sipas një plani monitorimi. Planet mësimore dhe syllabuset, ndryshohen për të siguruar përputhshmërinë me bazën ligjore por edhe për tu përmirësuar. Bazuar në RVB sikurse edhe në vizitën në institucion, GVJ evidenton se në nivel Fakulteti sikurse edhe në nivel Departamenti, bëhet analizë vjetore mësimore dhe kërkimore shkencore. Në analizën e përvitshme të departamentit bëhet edhe analiza e programit të studimit duke nxjerrë në pak arritjet dhe dobësitë sikurse edhe plan veprimin për përmirësim të mëtejshme. Në rastet kur ka nevojë për përmirësim në programet mësimore dhe në kurrikul, këto ndryshime pasi miratohen në nivel</p>

<p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>departamenti dhe fakulteti i përcillen për miratim në Senatën Akademik të UMT. Ky është akreditimi i parë që bëhet për këtë program studimi.</p> <p><i>Aneks Nr.88-Raportet e NJSBC per proc. mësimor.</i> <i>Aneks Nr.44-Formular Vleresim performance.</i> <i>Aneks Nr.80-Model i pyetësorit per studentet.</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Sikurse evidentuam edhe në kriterin më sipër, në nivel Departamenti dhe Fakulteti kryhet analiza vjetore mësimore dhe kërkimore shkencore e cila finalizohet me një raport që ndër të tjera evidenton ecurinë apo problematikat e programit të studimit. Në fillim të cdo viti akademik, bazuar edhe në raportin e analizës mësimore dhe kërkimore shkencore, hartohet objektivat, plan veprimi për motivimin e praktikave të mira si edhe masat për problematikat e evidentuara.</p> <p><i>Aneks Nr.88-Raportet e NJSBC per proc. mësimor.</i> <i>Aneks Nr.44-Formular Vleresim performance.</i> <i>Aneks Nr.80-Model i pyetësorit per studentet.</i> <i>Aneks Nr.35-Permiresimi i kurrikules.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Institucioni sikurse edhe gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstaton se Institucioni përdor një sërë metodash për vlerësimin e realizimit dhe mbarëvajtjes së programit të studimit. Kështu në nivel institucional, fakulteti dhe departamenti realizohet analiza mësimore dhe kërkimore shkencore, vlerësohet vazhdimisht kurrikula si edhe hartohet plan veprimi për përmirësim të vazhdueshme. Studentët gjithashtu kanë rolin e tyre në vlerësimin e stafit akademik, nëpërmjet anketimit i cili kryhet në përfundim të cdo semestri. Performanca e stafit akademik, në bazë të disa treguesve që lidhen me mësimdhënien, kërkimin dhe angazhin e tyre, vlerësohet nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe asaj kryesore.</p> <p><i>Aneks Nr.60-Raport vjetor i aktiviteti mësimor.</i> <i>Aneks Nr.88-Raportet e NJSBC per proc. mësimor.</i> <i>Aneks Nr.44-Formular Vleresim performance.</i> <i>Aneks Nr.80-Model i pyetësorit per studentet.</i> <i>Aneks Nr.35-Permiresimi i kurrikules.</i></p>

<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>GVJ konstatoi se UMT në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit Bachelor “Informatikë Ekonomike”, përdor metoda të drejtpërdrejta të vlerësimit si:</p> <ul style="list-style-type: none"> a- Nëpërmjet monitorimit nga departamenti, vlerëson cilësinë e mësimdhënies dhe vëzhgime në auditor; b- Kontroll të syllabuseve të lëndëve; c- Përshtatje e planeve mësimore; d- Vlerësim të organizimit të provimeve dhe detyrave të kursit; <p>GVJ konstatoi se UMT gjithashtu, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si:</p> <ul style="list-style-type: none"> e- Sondazhe me studentët e programit, cdo semestër para fillimit të sezonit të provimeve; f- Organizon takime me studentët, për tu thelluar në gjetjet e pyetësorëve, ku shpesh monitorimet planifikohen pas realizimit të takimeve me studentët; g- Komisione Ad-hoc monitorimi, vlerësimi; h- Pyetësor apo takime me studentët Alumni; <p><i>Aneks Nr.60-Raport vjetor i aktiviteti mësimor.</i> <i>Aneks Nr.88-Raportet e NJSBC per proc. mësimor.</i> <i>Aneks Nr.44-Formular Vleresim performance.</i> <i>Aneks Nr.80-Model i pyetësorit per studentet.</i> <i>Aneks Nr.35-Permiresimi i kurrrikules.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në RVB sikurse edhe në vizitën në institucion, GVJ evidenton se në nivel Fakulteti sikurse edhe në nivel Departamenti, bëhet analizë vjetore mësimore dhe kërkimore shkencore. Në analizën e përvitshme të departamentit bëhet edhe analiza e programit të studimit duke nxjerrë në pak arritjet dhe dobësitë sikurse edhe plan veprimin për përmirësime të mëtejshme. Në rastet kur ka nevojë për përmirësim në programet mësimore dhe në kurrrikul, këto ndryshime pasi miratohen në nivel departamenti dhe fakulteti i përcillen për miratim Senatit Akademik.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se UMT ka NJSBC, si njësi qendrore në nivel institucioni, që ka të sanksionuar në statutin e UMT, detyrimin për implementimin e procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë në UMT. NJSBC e garanton rolin e saj në bashkëpunim me njësinë bazë dhe atë kryesore, që janë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor “Informatikë Ekonomike”. Vendimmarrjet për përmirësimin e cilësisë pas rezultateve të vlerësimit, merren dhe zbatohen kryesisht në nivel departamenti dhe njësie kryesore, sic janë rishikim planesh mësimore dhe syllabusesh, apo mbarëvajtja e mësimdhënies.</p> <p><i>Aneks Nr.60-Raport vjetor i aktiviteti mësimor.</i></p> <p><i>Aneks Nr.88-Raportet e NJSBC per proc. mësimor.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Referuar takimeve me studentët dhe GVB, studentët janë të përfshirë dy herë në vit në plotësimin e pyetësorëve. Studentët e programit rezultuan gjithashtu pjesë edhe GVB. Studentët e UMT, kanë edhe përfaqësuesin e tyre në NJSBC, që mbulon komunikimin me studentët për proceset vlerësuese. GVJ konstatoi se edhe nëpërmjet rrjetit Alumni që institucioni ka, nëpërmjet pyetësorëve me Alumni, si dhe takimeve që ka zhvilluar me ta, institucioni siguron informacion për përmirësimin e programeve.</p> <p><i>Aneks Nr.80-Model i pyetësorit per studentet.</i></p> <p><i>Aneks Nr.35-Permiresimi i kurrikules.</i></p> <p><i>Aneks Nr.31- Rrjeti Alumni UMT.</i></p> <p><i>Aneks Nr.9-Vendim mbi ngritjen GVB.</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e</p>	<p>Pyetësorët zhvillohen anonim, duke ruajtur anonimitetin e përgjigjeve të studentëve. Departamenti përveç analizës së problematikave të hasura në tërësi, iu vendos në dipozicion në mënyrë individuale stafeve akademike të programit, rezultatet e vlerësimeve që studentët kanë bërë për lëndët që ata mbulojnë, pas përfundimit të procesit të provimeve dhe dorëzimit të procesverbaleve. Të gjitha procedurat, mënyrat dhe instrumentat e përdorura për vlerësimin e sigurimit të cilësisë bazohen në parimet e shprehura në Kodin e Etikës.</p>

administrative dhe studentëve e programit të studimit.	<i>Aneks Nr.3 -Rregullore UMT.</i>			
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Diskutimet zhvillohen mbi problematikat e mundshme, duke shmangur diskriminimin apo pabarazinë, kundrejt stafit akademik dhe studentëve. Ndër parimet kryesore të UMT, edhe parimi i integritetit dhe parimi i barazisë dhe respektimit reciprok të anëtarëve të universitetit. <i>Aneks Nr.44-Formular Vleresim performance.</i>			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vryera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Bazuar në RVB, si edhe në takimin që GVJ pati në institucion u konstatua se vazhdimisht merren parasysh mendimet e dhëna nga përfaqësues të bizneveve me të cilat UMT ka marrëveshje bashkëpunimi, sikurse edhe analiza e tregut të punës. Kjo ndihmon në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit. Gjithashtu eksperiencia qe stafi akademik ka në institucione të arsimit të lartë jashtë vendit, në kuadër të projekteve Erasmus, ndihmon gjithashtu në përmirësime të vazhdueshme të lidhura me mësimdhënien, kërkimin shkencor etj. <i>Aneksi Nr.79, Përbërja e NJSBC</i>			
Konkluzione	<i>Të gjitha procedurat, mënyrat dhe instrumentat e përdorura për vlerësimin e sigurimit të cilësisë bazohen në parimet e shprehura në rregulloren e UMT. NJSBC është përgjegjëse për zbatimin e procedurave për Sigurimin e Cilësisë në nivel institucioni. Përmes proceseve të vlerësimit dhe raporteve periodike, NJSBC bashkëpunon ngushtë me njësitë dhe departamentet për të ndërmarrë masa për përmirësimin e programit të studimit. Gjithashtu, pjesëmarrja aktive e studentëve në këto procese, përmes pyetësorëve anonim dhe përfaqësimit të tyre në NJSBC, siguron një perspektivë të rëndësishme për vlerësimin dhe përmirësimin e programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X




Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	GVJ referuar DVV dhe webit zyrtar të UMT, konstaton se politika, e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. NJSBC mbështet në Politikën e Sigurimit të Brendshëm të cilësisë, për të cilën studentët informohen nëpërmjet guidës së studentit, webit zyrtar apo stafit të NJSBC. <i>Aneks Nr.88-Raportet e NJSBC per proc. mësimor.</i> <i>Aneks Nr.9-Vendim mbi ngritjen GVB.</i> <i>Aneksi Nr.79, Përbërja e NJSBC</i> <i>Aneks Nr.3 -Rregullore UMT.</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	GVJ konstatoi se UMT harton raportet e vlerësimit vjetor të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Informacioni nga takimet me stafin akademik, iu jepet individualisht stafeve për të respektuar të drejtën e informimit si dhe për të adresuar problematikat, por njëkohësisht edhe në respekt të integritetit të secilit. <i>Aneks Nr.44-Formular Vleresim performance.</i> <i>Aneks Nr.60-Raport vjetor i aktiviteti mësimor.</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Sikurse edhe është theksuar në kriteret më sipër, pasi bëhet analiza mësimore dhe kërkimore shkencore në nivel departamenti dhe fakulteti, hartohen edhe masat në formën e plan veprimit për përmirësimin e dobësive të evidentuara në analizën e bërë. <i>Aneks Nr.35-Permiresimi i kurrikules.</i>




<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Gjithashtu eksperiencia qe stafi akademik ka në institucione të arsimit të lartë jashtë vendit, në kuadër të projekteve Erasmus, ndihmon gjithashtu në përmirësime të vazhdueshme të lidhura me mësimdhënien, kërkimin shkencor etj. Studentët e rrjetit Alumni gjithashtu japin mendimet e tyre ne lidhje me kurrikulat apo ndryshime të mundshme që duhet të ketë në to, duke qenë se ata janë prezent në tregun e punës.</p> <p><i>Aneks Nr.35-Permiresimi i kurrikules.</i></p> <p><i>Aneks Nr.31- Rrjeti Alumni UMT.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion, rezulton se UMT organizon trajnime me stafin rreth proceseve të vetëvlerësimit apo vlerësimit të jashtëm. Nëpërmjet stafeve administrative të NJSBC dhe studentit pjesë e NJSBC, studentët marrin informacion për pyetësorët dhe synohet që të nxitet angazhimi i stafeve dhe studentëve si dhe ndërgjegjësimi për sigurimin e cilësisë në institucion. Institucioni informon vazhdimisht dhe nxit studentët në pjesëmarrjen e tyre për plotësimin e pyetësorëve në përfundim të çdo semestri. Theksohet vazhdimisht tek studentët roli që ata kanë në monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë për programin e studimit duke i ndërgjegjësuar për plotësimin e pyetësorit online.</p> <p><i>Aneks Nr.80-Model i pyetësorit per studentet.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.79, Përbërja e NJSBC</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në faqen web të UMT, janë publike informacione dhe një sërë dokumentacionesh dhe veprimtarish që lidhen me cilësinë. Institucioni informon vazhdimisht dhe nxit studentët në pjesëmarrjen e tyre për plotësimin e pyetësorëve në përfundim të cdo semestri.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
---	--	-------------------------------------	------------------------------------	---

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Informatikë Ekonomike” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Metropolitan Tirana”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Bashkëpunimi efektiv i strukturave drejtuese, akademike dhe mbështetëse në shërbim të programit të studimit
2. Sistemi i informacionit i integruar dhe efektiv
3. Kurrikula bashkëkohore
4. Staf akademik me tituj dhe grada përfshirë edhe staf akademik të huaj me kontrate me eksperience ndërkombetare mësimesh
5. Procedura rekrutimi, transparente dhe të orientuara drejt cilësisë
6. Sistemi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë me mekanizma të diversifikuar dhe efektivë të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë
7. Struktura mbështetëse efektive për studentët, për informimin e tyre rreth programit, mundësive të punësimit si dhe për programet e shkëmbimit të tyre.
8. Mbështetja e studentëve me laptopë ofron një platformë të fuqishme për zhvillimin e aftësive teknologjike dhe përparimin në arsim.

Pika të dobta:

1. Hapësira fizike dhe kapacitetet pritëse të bibliotekës konsiderohen të pamjaftueshme për të plotësuar kërkesat e studentëve të të gjithë programeve që UMT ka [(Standarti IV.3, kriteri 3)].
2. Pavarësisht se thuhet se njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës, GVJ nuk evidentoi asgjë të dokumentuar në lidhje me këtë fakt. [(Standarti II.5, kriteri 1)].
3. Nuk ka institucionalizim të platformave në mënyrë që të rritet efikasiteti dhe transparenca në zbatimin e rregullave të parandalimit të plagjiaturës. [(Standarti III.3, kriteri 5)]

Rekomandime:

1. GVJ sugjeron shtimin e kapaciteteve fizike, posteve pritëse dhe kompjuterave në bibliotekën e UMT.
2. Krijimi i lehtësirave për studentët dhe stafin si parkimi.



3. Të përshtaten programi i studimit me standardet ndërkombëtare për të siguruar që studentët të jenë në gjendje të zhvillojnë aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për t'u integruar me sukses në tregun e punës ndërkombëtar.
4. UMT rekomandohet të përshtasë një platformë për kontrollin e plagjiaturës.

Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor " Economic Informatics" provided by the Higher Education Institution " University Metropolitan Tirana"

Strengths and affirmations

1. Effective cooperation among the managerial, academic, and support structures in service of the study program.
2. Integrated and effective information system.
3. Contemporary curriculum.
4. Academic staff with titles and degrees, including foreign academic staff with contracts and international teaching experience.
5. Recruitment procedures that are transparent and quality-oriented.
6. Internal Quality Assurance System with diversified and effective mechanisms for quality monitoring and assessment.
7. Effective support structures for students, for informing them about the program, employment opportunities, and their exchange programs.
8. Providing students with laptops offers a powerful platform for developing technological skills and advancing in education.

Weaknesses

1. The physical space and hosting capacities of the library are considered insufficient to meet the demands of all UMT programs' students. [(Standard IV.3, criterion 3)].
2. Despite claims that responsible units consult and take into account the proposals of partner institutions, graduates, and other actors from the labor market, the GVJ found nothing documented regarding this fact. [(Standard II.5, criterion 1)].
3. There is no institutionalization of platforms in a way that would increase efficiency and transparency in the implementation of plagiarism prevention rules. [(Standard III.3, criterion 5)].

Recommendation

1. GVJ suggests increasing the physical capacities, hosting facilities, and computers in the UMT library.
2. Creating facilities for students and staff such as parking.



3. Adapting the study program to international standards to ensure that students can develop the necessary skills and knowledge to successfully integrate into the international job market.
4. UMT is recommended to implement a plagiarism checking platform.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X




VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

